



# Dukagjini

**Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i VIII i botimit, nr. 120, Tetor 2013**

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355683191817, internet: www.shoqatadukagjini.org, Kryeredaktor: Lazër Kodra, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro



## LUMTURIMI QË LUMTURON... 6

**KRONIKË NGA AKTIVITETI NE QYTETIN E TUZIT ME RASTIN E 10-VJETORIT TË LUMTURIMIT TË NËNË TEREZES...**

nga Lazer Kodra

Në kujtim e për të nderuar veprën e Nënë Terezës, me rastin e 10-vjetorit të lumturimit të saj, ne Tuz, u dha spektakli, me teme "Shqipe engjëjlore e botes", e organizuar nga Unioni Artistik i Nacionalitetit Shqiptar, ne bashkëpunim me shoqatën "Dede Gjon Luli". Me këtë rast, Kryetari i Shoqatës "Dede Gjon Luli", Gjon Dushaj, na kishte bërë një ftesë, ne si "Shoqatë Atdhetare-Dukagjini". Shoqata jonë u bë pjesë e kesaj veprimtarie sa cilësore aq edhe të rëndësishme e të mirëorganizuar. Grupi i shoqatës sonë përbëhej nga Kryetari i shoqatës, Ndue Sanaj, Gjergj leqeja, Lazer Kodra, Roza Pjetri, Dukate Bregu, Mëhill Prroni, Silvana Arrinaj, e këngëtari Pëllumb Vrinca. Pas mbërritjes ishte, si gjithmonë, një kafe si simbolikë e mikpritjes e bujarisë që ushqehet nga shpirti i shqiptarëve kudo që ndodhen.

**KOMPOZITORI  
ZEF ÇOBA DHE  
KONTRIBUTI I  
TIJ NË MUZIKËN  
SHQIPTARE 5**

**PERSHENDETJA E PRESIDENTIT TE UNIONIT ARTISTIK  
NACIONAL, AZGAN HAKLAJ, NE VEPRIMTARINE KUSHTUAR  
10 VJEORIT TE LUMTURIMIT TE NENE TEREZES**

**Azgan Haklaj: Nënë Tereza,  
engjëlli shqiptar që me  
dashuri pushtoi qiejt 9**

**Kurrë  
Kosova s'qe  
Turqi, zoti  
Erdogan!**

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP

Mundësoi Botimin:  
**GJERGJ LEQEJZA**

**Ma.di.sh** **Kimay**  
PRODUCTION Produzione Giacche





# Kurrë Kosova s'qe Turqi, zoti Erdogan!



Nga Kadri Ujka

Në epokën e postideologjive, postskemave dhe posthumanizmit, ndryshe në Epokën e Individiumit, kur epoka astrologjike e peshkut ku njeriu diktohej nga të tjerët, ia ka lënë vendin epokës astrologjike te ujorit ku individi dikton vetveten, t'i diktosh një nacionaliteti të tërë, ndër më të vjetrit në kontinent, pre' e historisë së dhimbshme të një pushtimi gati 500 vjeçar osman, ku edhe gjuha do t'i ndalohej me ligj, mjerisht nga vendimi i një ish-kryeministri turk, me origjine shqiptare, si dëshmia më tragjike e shtjetërsimit sui-generis të shqiptarëve, do të thotë të vrasësh me logjikën tënde të absolutizmit epokën e logjikës kritike duke kryqëzuar përfundimisht të ardhmen tonë evropiane, të ëndërruar ndër breza.

Pa ngatërruar, kurrsesi, Perandorinë Osmane me shtetin modern turk, në marrëdhënie partneriteti serioz, normal dhe miqësor me shtetin modern shqiptar në ditët tona, si qytetar civil, apo si njeri i lirë, në epokën e posthistorisë, nuk mund të mos jem dyshues ndaj sjelljeve të cilitdo politikan, pavarësisht nga besimi i tij, fetar apo ateist, kur ai kërkon të hedh pilulat e helmit të filozofisë absolutiste, në epokën e postdogmave, ndërkohë që dyshimi metodik si vizion postmodern më vjen si obligimi më fisnik ndaj vetvetes dhe nacionalitetit tim, kur kujtojme se, nëse po vonohemi të bëhemi pjesë e Evropës së Re, ndryshe të realizojmë atë ëndërr që vjen nga Epoka e ndritur e Rilindjes sonë Nacionale, arsyeja e vetme është dhe vazhdon të jetë psikologjia orientale, aziatike në të gjitha praktikat dhe sjelljet tona si qytetarë dhe si politikanë.

Duke respektuar luajalitetin politik me cilindo vend në botë, aq më shumë me fqinjët ballkanas, pa ndërhyrje në punët e

tyre të brendshme, që do të përjetoheshin si dhunë shpirtërore ndaj kulturës, besimit dhe historisë së tyre, e vlerësoj maksimalisht takimin Thaçi-Rama-Erdogan, por duke mbajtur lart si të shenjtë, devizën e "Shqipërisë Evropiane", çka kam bindje kategorike se, kjo është edhe deviza e dy kryeministrave shqiptarë, njohës të historisë së popullit të tyre.

Dhe, kur përballë këtij objekti mbarëshqiptar kudo ndodhemi, Ju, si "vëlla", më ofroni shtrembërimin e historisë së Nacionalitetit tim, në emër të një nostalgjie perandorake (kujtoni doktrinën Davut Oglu-2008) jam i detyruar të citoj njëër nga dëshmitë më makabre "të pranisë" gati 500 vjeçare turke, nxjerrë nga "Kronikat" e Tursun Beut, kronikanit personal të Sulltan Mehmetit II: "Arsyeja e kësaj fushate të dytë në Shqipëri qe, sepse raca shqiptare është bërë e tillë, ngaqë në karakterin e saj kanë hedhur rrënjë mosbindja, këmbëngulja, rebelimi dhe arroganca ... Atëherë u dha urdhri ... që në çdo vendqëndrim të sillnin para Sovranit fitimtar meshkujt e lidhur me zinxhirë që luftëtarët guximtarë e të shkathët të Islamit t'i ekzekutojnë fap-fap ... Kështu u shkuan në shpatë deri në 3000, 4000, 7000 të pafetë, prej kufomave të cilëve, lugina të thella, tani, ngjasonin si të ishin kodra" (Pra kodra vëllezërisht të vrrarë prej vëllait të madh ... !?!).

Një kujtesë e tillë, aspak nën thirrjet anakronike të filozofisë së fronteve, por si një përvojë që nuk mund të mos konsiderohet, kur dihet se vlerësimi real i së kaluarës vjen si hipoteza e një të ardhmeje të qartë në rrugëtimin tonë si popuj, aq më shumë kur sindromi i "Turqisë vogël" për Shqipërinë së bashku me atë të Evropës së shekullit XX si kontinenti i të krishterëve tashmë janë totalisht të kapërcyer. Aq më kokëfortë vjen ky argument, kur dihet që në Evropën e Bashkuar ku synojmë filozofia e religjionit është totalisht e sfiduar nga filozofia progresiste e së Ardhmes demokratike, iluministe të Evropës së Re. Ndryshe sa kuptimplotë është kjo mes dy popujve ballkanas, që kanë si strategji të përbashkët gjetjen e vetvetes me dinjitet në Bash-

kimin Evropian. Personalisht nuk kam qenë kurrë dakord me idenë absurde se "paraardhësit tanë qenë me fat historik të jetonin nën sundimin osman gati 500 vjet" (Baleta), po aq as me idenë se "ata që u konvertuan në myslimanë ishin mëkatarë" (Kadare) në kontekstin e një mbijetese ekstreme, por nuk mund të mos jem plotësisht dakord me pohimin e shkrimtarit tonë të madh, të përmasave botërore, I. Kadaresë, kur ai shprehet: "... njëri nga turpet e mendimit shqiptar mbetet patjetër ideja e rremë se kombi shqiptar do të ishte shuar nga vala sllave, në qoftë se nuk do të na mbronin osmanët. Kjo, sepse sllavët ballkanas duke qenë vetë në një pozitë më poshtëruese se ne, ndryshe prej rajai, nuk kishin asnjë mundësi joshjeje, aq më pak asimilimi mbi të tjerët ... sidomos përballë identitetit sprapsë dhe kryeneç shqiptar" (shih esenë "Mosmarrëveshja - raporti i shqiptarëve me vetveten")

Këto, pa u ndalur në vitet 30-të të shekullit XX, ku myslimanizmi do të përdorej si karta e zbrazjes së shqiptarëve drejt Anadollit, apo ajo e ortodoksizmit si zbrazje drejt Greqisë, sikurse Marrëveshja ruso-turke, Kërçuk-Kajnarxhi, e vitit 1774 sipas së cilës Shqipëria do t'i dorëzohej totalisht influencës ortodokse ruse. Të gjitha këto veprime prej "vëllait" pushtues me bekimin dhe në kontekstin e nënshkrimit protokollor turk, si thika pas shpine ndaj nacionalitetit shqiptar.

Ju, zoti Erdogan, e dini se kur në Evropën e Re, gardiane e të cilës është vetë Turqia moderne, attribute të tilla si besimi fetar, flirtimi me dikë, ndryshe marrëdhëniet intime dhe vota e lirë janë ndër të drejtat themelore të individit, nuk mund ta kuptojë se si takimi në mes dy delegacioneve qeveritare të ketë si platformë të vetme gjatë gjithë protokollit qeveritar, mes delegacionit tuaj dhe atij kosovar, fatin e një xhamie në Prishtinë, siç shprehet deputetja Alma Lama nga Kosova, duke u kandidateur në fatin e një protokollit fetar, si mes dy kryemyftive të dy vendeve tona.

Ju lutemi, zotërinj politikanë, që vini sa nga Athina, sa nga Stambolli, kini kurajën civile dhe

dinjitetin maksimal, edhe pse jetojmë në epokën e pragmatizmit, të silleni ndaj vendit tim evropianisht, larg moralit hipokrit të kumtit të fjalës "vëlla apo vëllezërim" që më sjell ndërmend filmin aq elegant turk "Lugina e Ujqërve" (Kurthi). Na lini në pjesën tonë, të mbetur, të diellit, sepse vetëm dritë e diell prej vëllait dhe miku të sinqertë njohin bijtë e bijat e kësaj toke që quhet Shqipëri ndaj vëllezërve dhe miqve të vërtetë. Ne e kemi të qartë se, ndryshe nga politikat e moralshme, diktatoriale ku ushqehen kultet e këtij profili, apo politikat korruptive dhe kriminale ku mbahet gjallë krimi, në të gjitha format e shprehjes së tij, sikurse amoralitetin e politikës në postmodernitet ku dominon pragmatizmi, ndryshe mik, shok, vëlla e te tjerë, e te tjerë, të këtij lloji vinë thjesht "folklor", jashtë loje, por t'i tregosh kufijtë një n nacionaliteti shekuj e shekuj para teje në Ballkan, do të thotë të mohosh indirekt të drejtën e tij natyrale në hisen e tij të diellit, çka do të do të ishte e pafalshme për bashkëkombësit e mi të çdo pozicioni po të mashtrohemi para kësaj "nostalgjie perandorake të vëllezërve" duke rënë pre e një "Lugine të re Ujqërisht", ngado që të vijë. Ne, nuk mund t'ia lejojmë vetes të kërkojmë llogari çfarë bëni ju me kurdët, por nuk duhet t'ia lejojmë vetes as heshtjen ndaj fatit të emigrantëve shqiptarë në Turqi, që "sot përbëjnë 1/3 e parlamentit turk, ndryshe janë 50 deputetë me origjinë shqiptare, nga të gjitha partitë, duke pranuar kështu shkrirjen tyre si minoritet.

Kjo "... sepse këta emigrantë nuk guxojnë në asnjë rast të ngrenë probleme të natyrës etnike nga frika, se mos pësojnë fatin e kurdëve, ngaqë Turqia kurdoherë i përmbahet politikës së asimilimit të tyre në nacionalitetin turk" (Hysrev Tabak, Qendra e Kërkimeve dhe Analizave Strategjike, "Lindja e një minoriteti shqiptar në Turqi", kliko: [www.nacionalalbania.al](http://www.nacionalalbania.al)).

Ne, nderojmë solidaritetin tuaj me shqiptarët, gjatë Krizës shqiptare të 1997-ës, si solidaritet mes vëllezërve ballkanikë në një moment të vështirë historik, sikur nderojmë aktin e pilotit

turk, në mos qofsha i gabuar, që guxoi të godiste i pari mbi kështjellën serbe të diktatorit të Ballkanit, Millosheviç, më 24 mars 1999 në emër të çlirimit të Kosovës nga Serbia, por nuk do të kishte kuptim, nëse respektit dhe ndjesisë sonë prej një populli mik dhe tejet fisnik t'i serveshin doktrina famëkeqe si ajo Davut Oglu-2008, apo të na vihej në dyshim, me gjakftohtësinë maksimale, deri natyrshmëria e Kosovës si tokë shqiptare. Ju, zoti Erdogan duhet ta njihni mirë Historinë e Perandorisë Osmane ku besoj të jetë artikuluar qartë termi Krahinat e lira shqiptare si: Rrafshi i Dukagjinit (Kosovë), Shala, Shoshi, Hoti, Pulti, Mirëdita, Kurveleshi, Himara (Bregu) e te tjerë, të cilat, jo thjesht, kundërshtuan gjithë qeverisjen në bazë të ligjit islam, perandorak, të Sheriatit, por, përkundraz, do ta detyronin Portën e Lartë t'ua njihte me ligj të drejtën e qeverisjes sipas kanuneve të tyre, me tharm latin, siç do të thoshte Dr. Shuflai, edhe pse kurrsesi malësorët nuk pranuan sistemin e timarit. Madje, bie fjala, si gardianë këmbëngulës të gjuhës dhe të identitetit të tyre shqiptar, Hoti do të kishte kurdoherë në gjendje gatishmërie 4 000 burra nën armë, kurse Mirëdita 12 000 të tillë duke arritur më 26. 10. 1911 deri në formimin e Qeverisë së Parë të Përkohshme Shqiptare, të kryesuar nga Prengë Dodë Biba, e cila do të shtypej nga turqit, po aq sa çuditërisht nuk do te njihje as nga Vatikani. Gjitha këto, besoj, janë në argumentin historik të trojeve tona të natyrshme filluar me Kosovën në Verilindje deri në Jugun e Shqipërisë me vilajetin e mirënjohur të Janinës ku Ali Pashë Tepelena do ta tronditë vetë Portën e Lartë me aktin-legjendë: Dorëzoi kokën, por jo dinjitetin e një kryqeveritari në këtë vilajet shqiptar, të mirënjohur botërisht.

Kështu kam bindje kategorike z. Erdogan se, edhe në qoftë se nuk do të guxonin të tërhiqeni publikisht nga deklarata juaj antishqiptare: "Kosova është Turqi!", në koshiencën tuaj, prej një personaliteti madhor të popullit të nderuar dhe mik, turk deklarata juaj është totalisht e mohuar, sepse "Kurrë Kosova nuk qe Turqi!".

# Disa reagime

## NEN TRYSNIN E FILMAVE TURQ

Kam bere përpjekje nëpërmjet faqes se fb dhe komenteve të ndryshme për artikuj të shtypit të përditshëm që botohen në Republikën e Shqipërisë dhe në ato që botohen jashtë atdheut, në gazetën "Tribuna Shqiptare", që botohet në Kanada apo në revistën "Ëndrrat Shqiptare", që botohet në Miçigan, të reagoj ndaj tele-novelave turke, të cilat jepen me shumice në Televizorët Nacionale të hapësirës Shqiptare dhe Kosovare se, ato u bën pjese e familjeve tona në kuadrin e 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë.

Festimi i 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, duket si pak hipokrite në raport me atë që i jepet publikut Shqiptar dhe atij Kosovar se, nëpërmjet publikimit të "vlerave" të pushtuesit me shekuj, të atij otoman, të atij osman, siç është telenovela "Sulltani i Madhërisë" apo "Lugina e Ujqërve" e të tjera. Ne, nuk po kuptojmë se, ky i 100 vjetor i Shpalljes së Pavarësisë, ndaj kujt është shpallur dhe ne, pse e festojmë?! U tha se, do të vinte në këtë feste dhe Kryeministri Erdogan! Ai nuk erdhi në kuadrin e 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë ndaj pasardhësve të tij, por erdhi tani, me 23 tetor, në Prishtinë ...! Ne, jo në pak raste më pare dhe tani, kur duam të justifikohemi apo të kritikojmë prapambetjen tone në kulture, në nivel jetese, në mendësi bashkëjetese, në mungesën e tolerancës në politike, thoshim dhe vijojmë të themi: "Na ka lënë prapa 500 vjet pushtimi nga Perandoria Otomane apo Turqia". Me thënë të drejtën, a duhet kundërshtuar ky mendim? Them se po. Kalo një shekull dhe ne mund të ishim më përpara duke lënë prapa jo vetëm Turqinë, por dhe fqinjët për rreth, dhe jo ne të jemi prapa asaj dhe nga fqinjët tanë.

Ekranet shqiptare i kanë pushtuar filmat turq, me personazhe që në thelbin e tyre përfaqësojnë mllafe të akumuluar, urretje e vëllait për vëllamë, pabesi e nënës me fëmijët, intriga e diferencime brenda familjes, vrasje masive pa lloga-

rite gra, pleq dhe fëmije, vrasje kanunore ne grup, mos njohjen e shtetit e të tjera, e të tjera. Në të gjitha këto telenovela shikohet mungesa e shtetit dhe bandat apo dhe grupe shoqërore tregojnë që nuk e njohin shtetin, nuk kane besim te shtetit dhe menjëherë kalojnë në vetëgjyqësi. "Lugina e ujqërve" e mbushur tërësisht me vrasje, ku kriminelët mendojnë vetëm për shfarosje kundërshtarësh, mendojnë për prita dhe gjak. Rrëqethëse shfaqet vrasja e grave nga burrat e tyre. Një dukuri sa primitive aq edhe burracake. Një burrë që nuk përballon dot vështirësitë e kohës, gjen ngushëllim tek alkooli e droga, e më pas i kthehet dhunës në familje.

Shtroj një pyetje: Më mire të ndalohen filmat me krime nga më çnjerëzoret apo filmat erotike? Kohet e fundit, është rritur krimi në familje, është rritur kontingjenti i fëmijëve me prije kriminale! Kjo duhet të na shqetësojë seriozisht se, kjo rritje vjen nga edukata që marrin nga këto filma që jepen në kohën kur fëmija është prezent apo nga kush tjetër?

## NEN TRYSNINË E MASHTRIMEVE PËR GJAKMARRJE

Me 16 shtator 2013, ne TV1 Channel, kryetari i Pajtimimit të gjaqeve në Shkodër, në mes të tjerave deklaroi: "Në Qarkun e Shkodrës nuk shkojnë në shkollë 56 fëmijë për efekt të gjakmarrjes". Sekretari i kësaj organizate pajtimi, në mes të tjerave deklaroi: "Nuk shkojnë në Shkollë 32 fëmijë për efekt të gjakmarrjes. Madje, ketë e verifikova edhe në Drejtorinë Rajonale të Arsimit në Shkodër". Kryetari i Pajtimimit Mbarenacional, në gazetën "Shqiptarja.com", të datës 23 dhjetor 2012, në mes të tjerave ka deklaruar: "Qeveria shqiptare duhet të kishte punuar më shumë në luftën kundër Gjakmarrjes. Ne nuk e kemi ndjerë mbështetjen e tyre këtë vit, ndaj ne do vijojmë kritikën ndaj çdo partie që është në pushtet nëse nuk na mbështet në këtë mision fisnik ...". Kush janë këta, që kërkojnë ndihmën e qever-

ise? Qeveria që nuk ka punuar në këtë drejtim, për të siguruar shtetasit e vet, është e sakte, por nuk mund të ndihmohen organizata që mbështeten për zgjidhjen e problemeve me metoda arkaike, me metoda të një shoqërie primitive.

Ky, komitet me datën 5 shtator 2013, në këtë gazete, në mes të tjerave deklaroi: " ... ekspeditat në të gjitha rrethet kanë siguruar rezultat pozitiv, pasi deri më tani nga 910 fëmijë të cilët nuk mund të ndiqnin shkollën numri është ulur në 590 fëmijë, dhe nga 1670 familje të ngujuara një vit më parë, numri sivjet është ulur në 1208 familje të ngujuara ...". Atëherë, sipas këtyre treguesve, në vitin 2015 nuk do të kemi asnjë fëmije të ngjuar, nuk do të kemi asnjë familje të ngjuar!? Po, në këtë gazete deklarohet se, **600 gra të ngjuara ...** Me datën 13 tetor 2013, në gazetën "Shqiptarja.com", Kryetari i këtij Komiteti, në mes të tjerave deklaroi: "Gjakmarrja po kthehet në biznes nga një pjesë e misionarëve të licencuar nga ministria e Drejtësisë, ..., i cili kërkon ndërhyrjen e Qeverisë ...". Pse, tani u kujtua ky Kryetar, që organizatat e pajtimimit të gjaqeve janë kthyer në biznesmen!? Ato janë kthyer me kohe, madje ndoshta duke e ditur edhe ai vete, por tani ka ardhur koha për të rene lustra këtyre lloje enëve ...?!

Deri kur do të eci shoqëria e jone të pranojë të vete-mashtrohet nga këta mashtrues, të cilët pa turp bëjnë përpjekje të jetojnë mbi gjakun e njerëzve të pafajshëm, bëjnë përpjekje të kthejnë shoqërinë në primitivitet???

## DERI KUR QEVERITË SHQIPTARE DO TË VIJOJNË TË DORËZOHEN PARA MENDIMIT PRIMITIV?

Me rastin e fillimit të sezonit shkollor 2013-2014, Ministria Arsimit e Sportit, në mes të tjerave deklaroi: "... Falënderoi të gjithë individ e organizata që kanë ndihmuar fëmijët e ngjuar ...!". More, kjo Ministre si është e mundur të deklarojë publikisht, që Qeveria Shqiptare është e paafte të mbrojë shtetasit e vet? Si, kjo Ministre deklaroi se, sipas deklarimit të saj, shoqëria shqiptare me shtetin e saj

demokratik, pranon krimin e vrasjes?

Nuk e di, nëse këtë deklarim e pranon Qeveria Shqiptare?! Por, përderisa deri tani e ka pranuar se, nuk është hera e pare që strukturat e shtetit kane dhëne ndihma të ngjuarve, kane bere projekte për të dhëne mësim fëmijëve të ngjuar (deri tani deklarohen dhënie mësimi 50 fëmijëve, marre nga Raporti i Komitetit Mbarenacional), e të tjera e të tjera. Në një Kongres te tyre, ka marre pjese Z/v kryetari i Qeverise dhe në një tjetër merre pjese Presidenti i Republikës së Shqipërisë, çka vërteten dorëzimin e strukturave të shtetit tone para mendimeve dhe veprimeve të një shoqërie primitive. Dhe, këto deklarata, këto pjesëmarrje nuk janë shenje e mire se, nuk na japin shpresa për arritje të standardeve Evropiane, për të cilat kemi dekada që ëndërrojmë ti arrijmë. Prandaj, strukturat e shtetit duhet të ngrihen në këmbë për të mbrojtur shtetasit e vet, duke arritur standardet Evropiane. Një shtetas angleze para shume viteve me thoshte: "Qeveria mund të mos ketë buke më të dhëne. Kam mendësi për gjysme racioni dhe të jap gjysme racioni. Por, ajo qeveri që nuk mund të mbroje shtetasit e vet nga krimi, është e detyruar për të rene dhe të zëvendësohet ...!"

\*\*\*

Do të beja thirrje historianeve, psikologeve dhe sociologeve që të bashkohen, të bëjnë hulumtime, studime dhe të përcaktojnë qarte: Pse fenomeni i ngujimit apo nocioni i ngujimit ndodh vetëm në shoqërinë shqiptare kudo ndodhet ai dhe jo në shoqërinë serbe, në shoqërinë malazeze, në atë greke apo në atë italiane, e në të tjera shoqëri të botes demokratike? Mendoj se, këtu duhet të filloje puna dhe duke e përcaktuar këtë sa më të qarte, sa më të sakte, aq më mire do të gjejmë ilaçin e shërimit të kësaj sëmundje shkatërruese për një shoqëri.

Për këto reagime, do të kisha dëshire të përfshihen lexuesit e gazetës "Dukagjini", të japin opinionet e tyre, të japin mendimet e tyre, me qellim që të gjendet ilaçi i shërimit nga kjo sëmundje që vjen nga një shoqëri primitive.

NDUE SANAJ, Kryetari i Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini"

## SHQETËSIMI QË VAZHDOJNË ME VITE ...??



Në të gjitha shkollat 9-vjeçare te zonës te Dukagjinit ka dite që ka filluar viti i ri shkollor. Të gjithë jemi ndërgjegjshëm për nivelin e ulët të mësimdhënies në këto shkolla, diku për shkak të kualifikimit të pamjaftueshëm të mësuesve e diku për shkak të pjesëmarrjes dhe interesimit krejt të vogël të nxënësve. Por sikur të mos mjaftonte kjo, godinat shkollore në të gjitha komunat malore te Dukagjinit, në Shale, ne Shosh, ne Pult edhe në Shllak e Temal janë tejte të amortizuara.

Ka njëzet vite që investimet për mirëmbajtjen e tyre janë krejt të pakta dhe sipërfaqësore gati për të thënë në shumë nga këto shkolla, më shume është vëne dore për ti shkatërruar se sa për ti restauruar ... Mjaft i shqetësuar për këtë gjendja shpre-

het në një kontakt me ne, kryetari i Komunës Shale, Bal Vuksani, i cili në mes të tjerave shprehet: "... Duke përjashtuar në një fare mase shkollën e fshatit Theth në të gjitha fshatrat e tjera, ka mjaft probleme ... Shumë shqetësuese është kjo situatë për shkollën e fshatit Gimaj që ka një numër të konsiderueshëm nxënësish, por edhe në fshatrat Lotaj dhe Abat kushtet për të zhvilluar mësim nuk janë aspak të mira ...".

Të njëjtat problem ka edhe në Komunat e tjera të Dukagjinit, pak banorë që jetojnë atje në periudhën e dimrit, pak fëmije që i frekuentojnë ato godina që nuk ja vlen ti quash shkolla dhe pak eshte interesim nga ata që duhet të bëjnë diçka.

Këtu po shpreh mendimin tim, por gjithmonë pasi kam marre shume mendime dhe opinione në njerëzit që takoj çdo ditë. Padyshim, që njëra nga arsyt kryesore që i ka detyruar banoret e këtyre zonave të braktisin atë vend është mungesa e kushteve minimale për shkollimin e fëmijëve të tyre. Në pamundësi për të siguruar kushtet

e nevojshme për personel mesimdhënes të kualifikuar, ashtu edhe për kushtet nëpër shkolla, drejtoritë arsimore, kanë zgjedhur të heshtur në një kompromis me ata pak mësues të mirëfilltë që i mbulojnë këto shkolla ...

Heshtja është bërë zgjedhja jonë e vazhdueshme përball problemeve sociale, kulturore dhe historike të identitetit tonë, dhe si për çudi zgjohemi nga gjumi vetëm në periudha fushatash ...?? Çudi, abstraksion dhe naivitet me mjaft pasoja për të ardhmen tonë të afërt dhe të largët!

Ata pak banorë që varfëria i ka detyruar të vazhdojnë të jetojnë përsëri atje, ndihen të pafuqishëm për të ngritur zërin për këtë shqetësim të tyre, por edhe drejtuesit e Komunave ngrëne supet përball këtij fakti mjaft shqetësues ...

Godinat që shërbejnë për shkolla janë të mëdha dhe të mjaftueshme si ndërtesa, sepse aty dikur zhvillohej mësim në 8 klasa në të dyja ciklet shkollorë, por tani nga numri i paketit të nxënësve mësimi zhvillohet me klasa kolektive ..., por në këto kushte nuk ja vlen te quhet mësim.

Të gjitha këto shkolla kane nevojë për

investime, sepse shiu që bije jashtë e ka rrugën të hapur deri në fletoret e nxënësve ... nuk po flasim pastaj për bankat që kane mbi 30 vjet përdorim apo për xhamat që në shumicën e rasteve janë të zëvendësuar më plasmas ose dërrasa ...

Në kushte kur pushteti lokal thotë se, nuk ka fonde për ti riparuar e pushteti qendror duke filluar nga drejtoria arsimore, prefektura, e deri të Ministria e Arsimit, nuk e kane kuptuar ende se atje po rikthehet epoka Migjeniane e analfabetizmit ... dhe të bësh statistika pastaj nuk ja vlen ...?!

Jam i bindur se, ata që do ta lexojnë këtë shkrim janë të pafuqishëm sikurse unë, per te bere diçka ndryshe në shërbim te të mesuarit dhe dhenie dije fëmijëve dukagjinas!? Ata, që duhet ta lexojnë, të dëgjojnë dhe të vihen në lëvizje, kanë zgjedhur të bëjnë të paditurin, e megjithatë ketë radhe nuk e kam ndërmend të rreshtoj pasojat ...

Nuk mund të rri pa thënë se është koha që të gjithë ata që janë përgjegjës për këtë problem jo të vogël të marrin përgjegjësitë e tyre ... Të bëjnë një investim sado të vogël në ato shkolla sepse dimri po troket në derë ...

LULASH BRIGJA



# NË MES VORBULLAVE TË MISTERSHME TË INFINITIT



"E megjithatë asnjë njeri tjetër nuk ishte më modest se Ajnshtaini në posedimin e fuqisë së dijes, e më i sigurt se kjo fuqi është fatale" Duajt Aisenhoëer

"Kërkohe të zbulohen grimca me një energji më të lartë se ajo që quhet energjia e Planck-ut, dhjetë miliard, miliard GeV ku masa e saj do të ishte aq e koncentruar sa që ajo do të izolohej nga pjesa tjetër e Gjithësisë dhe do të formonte një vrimë të zezë të vogël. Sigurisht energjia e Planckut është shumë larg nga energjitë prej rreth njëqind GeV (100 miliard elektron volt gama-ray pulses), që përbëjnë sasinë më të madhe që mund të prodhojmë sot në laboratorët tona. Ne nuk do ta arrijmë që ta mbushim këtë boshllëk me akseleratorët e grimcave në të ardhmen e parashikuar." S.H.

Gjithësia, një Unitet Suprem i domosdoshmërisë ekzistenciale absolute me ekuilibrat dimencionuese shkak pasojë të rastësive, "noton" në mes vorbullave të mistershme të lëvizjeve të pafundësive të saj! Në thellësitë e tyre, veçanërisht në dekadat e fundit, janë bërë investime prej miliarda dollarësh për eksplorimin e të gjitha të fshetave të "themeleve" të Mikrokozmosit. Sipas shkencëtarit nobelist me famë botërore Stephen E. Haëking: "...Grimcat që më parë i quanin si "elementare" janë të përbëra nga grimca më të vogla. A është e mundur që, në të ardhmen, duke përdorur energji edhe më të mëdha, edhe këto të rezultojnë të përbëra nga grimca edhe më të vogla? Sigurisht është e mundur, por ne kemi disa arsye të mira teknike që të mendojmë se ne zotërojmë njohurinë mbi gurët e fundit të ndërtimit të natyrës..."Atje tek ata fshihen energji të përbindshme disa herë më të fuqishme se ato nukleare, forca të tmerrshme, të cilat qëndrojnë të "kyçura" e të "fjetura" si baroti në predhat ofensive të raketave!

Vini re! Ju flet CERN, Laboratori Evro-

pian i Kërkimeve në Fushën e Energjive të Larta! Një lajm i pa-precident! Fitore glorioze për Njerëzimin! Fizika avancoi njëqind vjet para! Kemi arritur në limitet e grimcave pafundësisht të vogla...! Në një Mekanizëm Gjigand, "Përplasësi i Madh i Hadroneve", 600 milion grimca në sekondë lëvizën me shpejtësinë e dritës. Nga kjo përplasje u "zbulua" "Grimca e Higgs-it ("Higgs-bosoni") ose grimca e Zotit ("God's partiale"), me një masë 100-200 herë superiore se bërthama e atomit ( protonit ), e cila ekziston vetëm për një të miliontën e një miliardës të sekondës para se të shkatërrohet e të shpërbëhet në grimca të tjera. Mendohet që ajo duhet t'u ketë dhënë masë fizike grimcave dhe lëndëve të tjera përbërëse të Universit!" Kjo grimcë, që ekziston "në një të miliontën e miliardës së sekondës", konsiderohet si "Zeusi i Gjenezës", "Shpirti i Gjithësisë" dhe "Lënda e parë e Krijimit". Por: "Ajo nuk mund të shihet, është thjesht teori. E shpikur nga Patër Higgs, në letër, e dëshmuar në formula të pafundme fizike dhe matematike. Ekziston? Studiuiesit e CERN-it janë pothuajse, por jo njëqind për qind të sigurtë".

Zbulimi i grimcave pafundësisht të vogla kërkon energji kolosale. "Stadet fare të hershme të Gjithësisë megjithatë përbëjnë një arenë ku energji të tilla duhet të jenë prodhuar. Unë mendoj se ka shumë të ngjarë që studimi i Gjithësisë së hershme dhe kërkesat me logjikë matematike mund të na çojnë në një teori plotësisht të njësuar kur akoma ndokush nga ne do të jetë i gjallë, gjithmonë duke supozuar se deri atëherë nuk do ta kemi hedhur në erë planetin tonë." Një Histori e Shkurtër e Kohës "Stephen E. Haëking.

Filozofia, udhërrëfyesja e të gjitha dijeve, apelon: Kujdes me themelet e Gjenezës! Edhe Mikrokozmosi është pafundësia! "Grimcat", në intervalet e kohës qindra miliona miliardë trilionë pjesë të sekondës dhe më tej drejt infinitit, s'janë gjë tjetër veçse ekzistenca deri tani të pazbuluara të Natyrës, zbulimi i të cilave avancon Përparimin dhe nga ana tjetër hap shtigje tepër të rrezikshme me pa-

soja fatale për Njerëzimin.

Big Bengu ose Shpërthimi i Madh është rezultat sine qua non i një kondensimi të paimagjinueshëm, "Singularitetit" të përmasave supërgjigande të Materies. Ajo, rreth 13 miliard vite më parë, në rrethana ekskluzivisht të papërcaktuara, domosdo do të shpërthente për të kaluar në një stad të ri shumë herë më të avancuar dhe krejtësisht ndryshe, duke çliruar furishëm brenda pak sekondave të gjithë energjinë e grumbulluar të qindra miliardave jave, planetëve dhe objekteve të tjera kozmike të kthyer në supernova, vrima të zeza etj.

Gjithësia ka pasur një fillim, një limit vazhdimësie dhe një ditë pas disa dhjetëra miliarda vitesh do të asgjësohet!!! Në vend të saj profetizohet mos ekzistenca, errësira, asgjëja, zeroja absolute, paradoksi dhe absurdi! Universi u krijua për tu asgjësua! Ata zbuluan mendimet e Perëndisë! Ia kaluan edhe Ainshtajnit!

"Libri Filozofik Materialist Dialektik i Gjenezës" tregon origjinën, kushtet, faktorët dhe rrethanat jashtëzakonisht të vjera dhe mrekullisht të favorshme, që përcaktuan lindjen e jetës, e cila ndodh në intervalet e kohës ku një e miliona pjesë e sekondës e moshës mesatare të njeriut është e barabartë me një miliard vite dritë të ekzistencës së përjetshme të Materies." Trupat albuminoid: "Motorët" e Jetës. Oksigjeni djegë "karburantin", bukën tonë të përditshme...! Me kalimin e viteve, në çdo moment, "erozioni" godet duke sjellë amortizimin e pashmangshëm.... Në fund plakja dhe "Pushimi i Pasosur". Amen!

"Nga vijmë dhe ku shkojmë". Ne vijmë nga thellësitë e Universit dhe si domosdoshmëri shkojmë përsëri drejt "Pikës së Nisjes", pafundësive. Fara e jetës, moshë e të gjithë gjallesave si total s'ka kufi as limit në kohë e hapësirë. Ajo është e përjetshme! Çdo krijesë është rezultante e metamorfozave të pa fund të transformimeve gjatë miliarda viteve e "zjarrit" të yjeve, dritës dhe ngrohtësisë së Diellit, i cili në çdo moment na dhuron bujarisht energjinë e tij jetëdhënëse

A ekziston Përjetësia? Një aspiratë prehistorike e Njerëzimit! Prej disa dekadave vazhdojnë me sukses kërkimet dhe eksperimentimet e shkëlqyera laboratorike për krijimin e jetës nga bota inorganike si edhe për zbulimin e "Çelësit Magjik" të "Kasafortës së Përjetësisë". Nga ana tjetër janë ndërtuar sisteme kompjuterike të sofistikua ultra moderne, "Njerëz Robot", të cilët gjithsesi s'mund të jenë identik me albuminën e gjallë, e cila nga vetë natyra, karakteristikat, cilësitë dhe vetitë e saj vetëm ajo ka aftësi të "prodhoj" mendimin, sado fill-estar, arsyetimin, perceptimin, analizën e sintezën, induksionin e deduksionin, imagjinatën, ndjenjat, reflekset, dëshirat, gëzimet, kënaqësitë, dhimbjet deri tek labirintet e pafund të shpirtit.

Në kuptimin më të plotë dhe të gjithan-shëm filozofik vdekja nuk ekziston! Ajo ashtu si lindja janë dy pjesë të kundërta të një Uniteti! Asnjëra s'mund të ekzistoj pa tjetrën! Gjithçka lëviz e ndryshon dhe për një moment "ndalon" për të kaluar në një stad ndryshe, drejtë pafundësive! Te bota inorganike e ka zanafillën "mizorja", e cila sado e "lehtë" dhe e "ëmbël" që mund të vijë, ka një fund tragjike! "Terrori i vdekjes është pasiguria e asaj që na pret. Përgjigja është e thjeshtë dhe qetësuese: ekzaktësisht e njëjta situatë si para se të ishim" Morandoti .

Dilema e Njerëzimit: "A ka jetë pas vdekjes? Ajo ndodhet, jo në përfytyrimet fataliste mistiko- obskurantiste të shkruara e gojore, por në vorbullat e mistershme të atomeve të hidrogjenit, elementit numër një të tabelës së Mendelejevit; të dritës dhe energjisë së Diellit si edhe të qindra miliarda trilion yjeve..., të cilët si total gjatë ciklit të përjetshëm të lëvizjes s'kanë mortje kurrë. Materia, në kushte e rrethana një milion miliard zero pas njëshit, pas disa miliarda viteve e "inspiruar" nga "Hyjnia Universale", ku asnjë mendje inteligjente s'mund ta zbulojë, do të krijojë përsëri ekuilibrat e nevojshme për jetën, si dikur kur jetonim ne, ndoshta vetëm në një planet X të një galaktike Y.

Luigj Temali

## NJOFTIM!

Me datën 26 tetor 2013, u zhvillua Mbledhja e Përgjithshme e degës së Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", në Tirane. Mbledhja u zhvillua me përgjegjësi për të ecur më me shume korrektësi në zbatim të vendimeve të Konferencës V të Shoqatës. Ajo, e pa të arsyeshme për të zgjeruar anëtarësinë e shoqatës me djem e vajza, të cilat janë të shkolluar ne Tirane. Gjithashtu, përderisa në Tirane ka mjaft intelektual, profesor, sociolog, shkrimtare dhe biznesmen dukagjinas, duhet ti afrojnë më shume dhe me ta kane mundësi ti përgjigjen me mire misionit të Shoqatës.

Në fund, u ben zgjedhjet e degës. Kryetar i degës u zgjodh Zef Bari, ndërsa anëtar të kryesisë u zgjodhën: Biznesmeni Gjergj Vocaj, N/Kolonele Tringa Rapi, profesor as. Dr. Zef Gjeta, aktivistja Lena Ndrevataj, biznesmeni Fran Molla, inxhinieri i pyjeve Gjon Fierza, biznesmeni Tom Shpendi dhe veterani Prek Kosturi. Sekretar i Kryesisë u zgjodh N/kolonele Tringa Rapi.

Redaksia

# KOMPOZITORI ZEF ÇOBA DHE KONTRIBUTI I TIJ NË MUZIKËN SHQIPTARE

Nga RAMAZAN ÇEKA,  
Poet popullor

Zef Çoba është kompozitori i këngës së famshme "N'xhamadanin vija-vija" dhe ky shkrim kushtuar atij meriton të fillohet kështu.

Shkodra është një qytet i madh, i bukur e plot jetë, me rëndësi të madhe historike dhe bashkëkohore. Ajo është një qendër e rëndësishme akademike, shkencore, kulturore dhe sportive. Dhe jo më kot shpesh quhet edhe "Metropoli i Veriut". Natyra e mrekullueshme, trashëgimia historike, zhvillimi i sistemit urban, pedonalet, lulishtet dhe shatërvanët, vajzat dhe djemtë e bukur dhe të shkathët, njerëzit e qeshur dhe gazmor, e bëjnë këtë qytet të dashur dhe të këndëshëm për këdo. Arti dhe kultura janë ato që Shkodrën nuk e m'plakin kurrë, sepse ajo jo vetëm që ka lindur në një djep kulture, por si një nënë e mirë vazhdon të përkundë edhe sot e kësaj dite këtë djep. Tashmë muzika shkodrane si pjesë e këtij djepi njihet mirë dhe pëlqehet nga çdokush. Këngët e bukura shkodrane epike, lirike dhe në veçanti jaret e famëshme, ka kohë që kanë kaluar kufijtë e Shkodrës dhe janë bërë të njohura duke u interpretuar dhe studiuar në Shqipëri dhe në Botë.

Personalitetet e artit dhe muzikës, krijuesit e mëdhenj, e thënë me plot gojën, janë një kështjelle tjetër për këtë qytet. Në themelet e kësaj kështjelle kanë vënë gurë të çmuar mjeshtrat: Prenk Jakova, Pjetër Gaci, Çesk Zadeja, Tish Daija, Tonin Harapi, e të tjere. Në këtë rrugë do të ecte edhe kompozitori i mirënjohur Zef Çoba.

Komisioni i vlerësimit të figurave në fushën e artit pranë Ministrisë së Arsimit e vleroi Zef Çoben me titullin "Profesor" duke e emruar si rektor në Akademinë e arteve në Shkodër. Ai ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e muzikës shqiptare, me formë e përmbajtje nacionale dhe bashkëkohore njëherazi, si krijues, pedagog dhe drejtues i institucioneve të kësaj fushe. Ishte një rast i veçantë momenti i akordimit të titullit "Profesor".

Prof. Zef Çoba ka lindur në Shkodër më 17 korrik 1951, në një familje qytetare. Shkodrane Pasioni i tij për muzikën ka filluar që në moshë të re.

Ka mbaruar Institutin e Lartë

të Arteve në vitin 1974, në degën e dirigjimit koral. Ka filluar punën në Peshkopi si përgjegjës muzike pranë shtëpisë së Kulturës të këtij qyteti. Këtu përveç hulumtimit të pasurive folklorike të kësaj krahine, fillon të vihet në jetë pasioni i tij për kompo-

tur që në qytetin tonë vazhdon të kontribuojë me emrin dhe punën e tij, si figurë shumë dimensionale, artisti i kompletuar prof. Zefi. Gjithashtu mendoj se vepra shumëplanshe dhe aktiviteti i tij artistik që vazhdon me intensitet, i tejkalon çdo koment



zicionin frytet e të cilit nuk vonojnë. Pas një qëndrimi shtatë vjeçar në qytetin e Peshkopisë në vitin 1980, me të njëjtin detyrë emërohet në Shtëpinë e Kulturës së qytetit të vet të lindjes. Gjatë kësaj periudhe janë edhe kompozimet e tij për festivalet e fëmijëve që zhvilloheshin në qytetin e Shkodrës. Prej vitit 1991 do të punojë pranë Radio "Shkodrës" si specialist i programeve muzikore. Që nga viti 1997 është drejtues artistik i korit "Schola Cantorum Dom Mikel Koliqi" të Shkodrës.

Vitet në vazhdim do të flasin për një kompozitor të kompletuar, gjë që bëri që në fushën kinematografike të kompozojë muzikën e më se 15 filmave. Ai mori edhe disa çmime në Festivalin e Filmit Shqiptar. Kështu mund të përmendim Medaljonin e Festivalit për muzikën e filmit "Skëterrë '43", në Festivalin IV të Filmit Shqiptar, si dhe Medaljonin e Festivalit për muzikën e filmit "Muri i gjallë", në Festivalin VIII të Filmit Shqiptar të vitit 1989 dhe së fundi kompozimi i muzikës së filmit "Dashuria e fundit" në vitin 1994.

**Zefi është një njohës i mirë i muzikës së mrekullueshme botërore dhe asaj shqiptare.**

Në një bisedë me shefin e muzikës të Qendrës Kulturore "Pjetër Gaci", Bardhyl Hysa mësuam se: "Në qytetin e Shkodrës Zef Çoba është figura më e respektuar që përfaqëson plejadën e muzikantëve që i kanë dhënë emër këtij qyteti. Duke qenë pjesë e artit muzikor e ndjej veten krenar dhe shumë i lum-

dhe fjalë që mund të thuhet për Zefin. Është një fakt i pa mohueshëm që mbas emrave të mëdhenj që Shkodra ka nxjerrë në fushën e muzikës. Zefi është vazhduesi i vlerave dhe i garancisë së kësaj trashëgimie".

Ndërsa prof. Hasan Lekaj konfirmon për Zefin: "Mbi të gjitha ka vlera të jashtëzakonshme njerëzore, pikërisht ky është burimi i vlerave të mëdha artistike, çka lidhet me njohjen e mentalitetit e veçorive dhe karakteristikat e popullit Shqiptarë që ai nuk i asimilon por i rikrijon me një origjinalitet të veçantë".

Ja si shprehen artistët për Zefin: Mjeshtri i Madh, këngëtar i Bujar Qamili e vleron kompozitorin Zef Çoba: "Një personalitet i jashtëzakonshëm dhe tepër i veçantë në komunikim me këngëtarët, veçanërisht me mua si Bujar, kur diskutohet për këngën popullore qytetare dhe një muzikant e kompozitor me vlera shumë të mëdha artistike, i cili ka lënë gjurmë në muzikën Shqiptare, prandaj meriton respektin dhe falenderimet e mia si artist".

Në festivalin e parë të këngës popullore Qytetare Shqiptare organizuar në Tiranë në vitin 2012, nga RTSH me krijime të reja nga 10 këngëtarët më të mirë të Shqipërisë, duke përfshirë këtu edhe këngëtarin nga Kosova Shkëlzen Jetishin dhe këngëtarin nga Maqedonia Selami Kolonja, profesor Zefi u përfaqësua me një kompozim të përkryer, me tekst të profesor Alfred Çapalikut, titulluar "E bukur si hanë" kënduar nga

Mjeshtri i madh Bujar Qamili, këngë e cila u ekzekutua nga orkestra famoze e RTSH, ku pati një sukses të jashtë zakonshëm duke u mirëpritur me duartrokitje gjatë gjithë kohës nga publiku që kishte tejmbushur sallën e Teatrit të Operës dhe Baletit në Tiranë.

18 vjet më parë, brenda pak orëve, kompozitori Zef Çoba dhe poeti Alfred Çapaliku krijuan këngën aq shumë të njohur "N'xhamadanin vija-vija". Tashmë kjo këngë këndohet e dëgjohet gjithandej nga shqiptarët e të gjitha moshave dhe është kthyer në një këngë mit, një këngë që frymëzon dhe lidh brezat. Autorët e kësaj kënge edhe sot e kësaj dite tregojnë me pasion e krenari për historinë e lindjes së saj në vitin 1993 në qytetin e Shkodrës dhe që u këndua për herë të parë nga këngëtarja e mirënjohur kosovare Shkurte Fejza.

Kompozitori Zef Çoba kujton: "Kam marrë shumë çmime, por ajo që më krenon më shumë është kur më 2 shtator të vitit 2002, në ndeshjen miqësore Kosovë-Shqipëri i gjithë stadiumi buçiste duke kënduar refrenin e kësaj kënge". Ky është çmimi më i madh për Zef Çobën.

Ndër të tjera ai shton: "Krijimtarinë time e kam shumë të lidhur me ndërgjegjen nacionale. Kam studiuar shumë etnosin dhe folklorin tonë muzikor dhe kur krijova këtë këngë isha me një "ngarkesë" të tillë nacionale. Kur isha në një koncert me një grup nga Shkodra pata fatin të bija në kontakt me shqiptarët e Kosovës. Emocionet dhe përshtypjet ishin të jashtëzakonshme. Më pas, rashë dakord për këngën me këngëtaresh Shkurte Fejza dhe shkova menjëherë tek miku im poet Alfred Çapaliku. Ishin orët e vona të natës dhe i thashë të çohet nga gjumi dhe të fillonim menjëherë punën. Atë natë kemi punuar deri në orën 4 të mëngjesit dhe në orën 5 gjithçka ishte e mbaruar."

Poeti Alfred Çapaliku, autori i tekstit të këngës "N'xhamadanin vija-vija", thekson: "Në darkë vonë më erdhën në shtëpi Shkurte Fejza me bashkëshortin dhe miku im Zef Çoba. I thashë gruas t'i shërbente miqve dhe vetë u futa në dhomë për të shkruar i qetë tekstin e këngës. Mora frymëzim nga Shkurte Fejza dhe nisa tekstin si një udhëtim, udhëtimin që kishte bërë

këngëtarja nga Kosova për të ardhur në Shqipëri. Më vjen mirë që kjo këngë po e humb autorësinë dhe është bërë popullore".

Forca sugestionuse artistike bëri që kjo këngë të fitojë popullaritet dhe u bë si Himn Nacional i dytë për gjithë shqiptarinë. Për 18 vite autorët e saj nuk ishin evidentuar, sepse tashmë ajo ishte kthyer në një këngë mbarë popullore.

Zef Çoba ka kompozuar vepra dhe pjesë të ndryshme vokale e instrumentale, këngë në stil të traditës së këngës qytetare shkodrane, shumë prej të cilave kanë fituar popullaritet absolut, këngë për fëmijë e te tjera. Ka kompozuar një cikël me romanca vokale të titulluar "Kënga e njeriut", ciklin me këngë korale për fëmijë "Edrejta dhe e shtrembra", shumë përpunime këngësh popullore për kor, për solistë e te tjere.

Në vitin 1999 ka themeluar në Shkodër Shoqatën Miqtë e Muzikës "Rozafa Expression". Shoqata zhvillon me sukses një aktivitet artistik e kulturor, nacional e ndërnacional.

Është karakterizuar për drejtim nga një punë me disiplinë e kërkesa të larta artistike, për këtë në turnetë e zhvilluara si brenda dhe jashtë vendit, është vlersuar me konsiderata të larta. Si kompozitor dhe dirigjent është nderuar dhe vlersuar me çmime të ndryshme.

Zef Çoba është nderuar me shumë tituj nderi: „Naim Frashëri“ i Klasës III - Urdhëri i dhënë nga Presidenti i Kuvendit Popullor në vitin 1989, „Nderi i Kulturës Dibrane“, vlerësuar nga Këshilli Bashkiak i Peshkopisë, „Anëtar nderi“ i Shoqatës Kulturore Artistike „Besa“ në Mal të Zi, „Anëtar nderi“ i Shoqatës „Madonna di San Giovanni“ Ripatransone-Itali, e te tjere.

Profesor Fadil Kraja, dramaturg i mirënjohur, thotë për prof. Zef Çoben se: „Është muzikolog i kompletuar i shumë dimensioneve, kompozitor i nderuar në shkallë mbarënacionale, lëvrues i të gjitha zhanreve muzikore, dirigjent me peshë, pedagog shumë i përgatitur, erudit. Ai thotë me bindje se pa emrin e Zef Çobës, muzika shqiptare dhe historia e saj do të ishte më e varfër“.

Aktualisht Zef Çoba është profesor në Akademinë e Arteve në Tiranë, pranë Katedrës së Dirigjimit, si dhe rektor në akademinë e arteve në Shkodër.



# LUMTURIMI QË LUMTURON...

**KRONIKË NGA AKTIVITETI NE QYTETIN E TUZIT ME RASTIN E 10-VJETORIT TË LUMTURIMIT TË NËNË TEREZES... nga Lazer Kodra**

Në kujtim e për të nderuar veprën e Nënë Terezës, me rastin e 10-vjetorit të lumturimit të saj, ne Tuz, u dha spektakli, me teme "Shqipe engjëjlore e botes", e organizuar nga Unioni Artistik i Nacionalitetit Shqiptar, ne bashkëpunim me shoqatën "Dede Gjon Luli".

Me këtë rast, Kryetari i Shoqatës "Dede Gjon Luli", Gjon Dushaj, na kishte bërë një ftesë, ne si "Shoqatë Atdhetare-Dukagjini". Shoqata jonë u bë pjesë e kesaj veprimtarie sa cilësore aq edhe të rëndësishme e të mirëorganizuar. Grupi i shoqatës sonë përbëhej nga Kryetari i shoqatës, Ndue Sanaj, Gjergj leqejza, Lazer Kodra, Roza Pjetri, Dukate Bregu, Mëhill Prironi, Silvana Arrinaj, e këngëtarë Pëllumb Vrinca. Pas mbërritjes ishte, si gjithmonë, një kafe si simbolikë e mikpritjes e bujarisë që ushqehet nga shpirti i shqiptarëve kudo që ndodhen.

## BEFASIA E NJË VIZITE...!

E kishim njohur disa vite më parë etnografin Shtjefen Ivezaj, ndoshta skajshmerisht, por kureshtja besoj se na kishte ngacmuar shpeshherë për të parë nga afer atë për të cilin flitej shumë dhe shkruhej herë pashere, për të parë Muzeun e Tij etnografik. Grupi ynë u drejtua për tek shepia e Shtjefnit dhe për pak minuta u ndodhëm përballë saj. Pamja e jashtme nuk e di se si por ishte aroma ndjellmirëse e asaj çfarë shikua brenda. E



zonja e shtëpisë, një grua në të cilën ishin harmonizuar mosha, pamja, fjala e burrëria na priti duke na thënë: "Mirëseerdhët o miqtë e shoqatës së Dukagjinit!". Në korridorin e shtëpisë qendronte një tavolinë e shtruar, mbi të cilën qendronin përherë rakia, vera, birra, e pije të tjera për miqtë e shumë të s' shkishin të ndarë. Më vjën keq, -u shpreh e zonja e shtëpisë, -që Shtjefni nuk është këtu, por Pasha Zotin vjen u ju takon te kisha sonte! Muzeu, i pershkruar me pak fjalë, ishte galeri e vërtetë ku brezat ishin përjetësuar me kulturen materiale e shpirtërore, falë përkushtimit të pashoq të shqiptarit të mirë



Shtjefen Ivezaj. Ngado të hidhje sytë të shfaqej 'rezervati' gjenik i kulturës së thellë etnografike të popullit tonë. Kohën e kishim të paktë, por ajo na mjaftoi sa për krijuar dimensionin e pamasë të punës së Shtjefen Ivezajt...punë e cila meriton vemendjen e shoqatës dhe gazetës sonë. U larguam për madhshëm, por kështu është më mirë, pasi malli të tërheq për rikthim të shpejtë në atë shtëpi- emblemë të shqiptarizmit.

## NË KISHË... ATY KU SHPIRTI I ZOTIT BËHET PJESË E SHPIRTIT TË NJERIUT!

Në kishën madhështore të Tuzit nuk kish se si të ndodhte ndryshe, përveçse prania e qindra pjesëmarrësve në meshën e veçantë me rastin e 10-vjetorit të lumturimit të Nënë Terezës. Përkatesia e besimit në këtë rast e kishte humbur dallimin. Aty kishte nga të gjithë, sepse për të gjithë ishte edhe Nëna e Madhe që na kishte bashkuar në këtë aktivitet. Mënyra e kulturuar e qendrimit të të qindra personave në Kishë,



vemendja në ndjekjen e vemëndëshme të të gjitha riteve, shkëndijimmi i syve nga përthithja shpirtnore e fjalëve të Zotit krijonin imazhin e një Parajse të vërtetë, në qoshen e Sëcilës qendronte shtatorja e Nënë Terezës. Tenori Kastriot Tusdha me interpretimin e këngës "Ave Maria" i 'ngriti' shpirtat e të pranishmëve drejt qiellit, dejt Nënë Terezës. Mesha e celebruar



nga Pater Pashko Gojçaj, për të cilin banorët e Tuzit shpreheshin: "Pater Pashkoja nuk është thjeshtë një frat, por është një pjesë e shkëputur nga vetë trupi i Zotit", i ngjante një himni të ringjalljes. Pas meshës, qindra pjesëmarrës vendosën lule e kurora pranë shtatores së Nënë Terezës. Kjo nuk ishte fundi i veprimtarisë, pasi një staf tjetër i mrekullueshëm po fshinte djersët e fundit pas një pune të lodhshme artistike, të cilën e konvertuan, siç dinë ata, në shtëpinë e kulturës para qindra e qindra spektatorëve.

## NGA TEMPULLI I ZOTIT NË TEMPULLIN E KULTURËS...

Ashtu si në Kishë edhe në Shtëpinë e Kulturës së këtij qyteti salla ishte e mbushur si asnjëherë tjetër, kështu shpreheshin banorët e Tuzit. Gjithëçka në funksion të nderimit të Nënë Terezës. E kush më mirë mund ta shprehë adhurimin për njerëzit e mëdhenj, se sa vetë arti i buruar nga shpirti i artistit e i mishëruar në jonet fonike që pushtojnë ndjesitë tona? Kjo ndodhi në atë mbrëmje sa magjike aq edhe befasese. Prezantuesja, e cila meriton mirenjohjen e të gjithëve për atë çfarë anonçoi, solli para spektatorit njëri pas tjetrit vlerat më të spikatura të fushës së artit shqip-





tar. Tenori dhe këngëtari Kastriot Tusha ngriti në këmbë qindra spektatorët e salles me këngët e tij, përfundimi i sëcilave u shoqërua për dhjetë minuta me duartrokitje të zjarrta. Po e njëjta gjë do të ndodhte me "Artistin e Merituar", Mirush Kabashi. Njeriu syqelq, gojëxhevahir, plot brilantinë, me recitimet e tij mbajti pezull frymën e të pranishmëve dhe jo vetem kaq, pasi një shi lotësh pushtoi dhjetra e dhjetra të pranishëm. Arti i mirë ka edhe lot! E para ishte fjala..! Pjestarët e Ansambllit të Këngëvë e Valleve Popullore Rexhep Çeliku e Liljana Cingu e ngriten sallën në këmbë me interpretimet e tyre të shkelqyera të valleve popullore e pjesëve të ndryshme koreografike. Imazhi i fluturimit të shqiponjave trupëzohej në finesën mjeshtërore të artit t'kulluar të valles. Këngëtari Pëllumb Vrinca nëpërmes një kënge epike deshmoi talentin e tij dhe ngriti lart vlerat e prezantimit të shoqatës sonë, pasataj interpretimi në duet, i një lirike, me këngëtares e mirënjohur Marie Lajçaj i 'çtensinoi' spektatorët e mbushur plot emocione. Tenori Shkodran Tolaj me bashkëshorten e tij ishin prurja e shkelqyer e këtij aktiviteti mbresëlënës. Virtuoziteti, eleganca interpretative, shkrirja këngë-aktrim, saktësia intonative, fuqia përçuese që domostruan u shprblye me qindra duartrokitje e përshëndetje të mëpastajme nga të pranishmit. Aktorja e re nga Tirana (falje për mungesën e emrit-shenimi im-L.K) na sollin një Nënë Terzë të vërtetë në skenen e shfaqjes. Përshëndetja e Kryetarit të Unionit Artistik Mbarëkombëtar, Azgan Haklaj



deshmoi së tejmi vlerat e bashkëjetesës fetare në Shqipëri, rolin e pakrahasueshëm botërisht të Nënë Terezës në fushën e humanizmit dhe paqes.

### JASHTË KORNIZAVE TË AKTIVITETIT, POR PËRSËRI ART E KULTURË.

Në darkën e shtruar për të pranishmit, me këtë rast, ajo që përmendej më pak ishte ushqimi, ndonëse me një menu të rrallëherë të parë e shijuar. Mes artistësh e misionarësh minutat nuk ekzistojnë, ndërsa orët shkojnë sikur të ishin minuta. Edhe në këtë darkë vallja, kënga, fjalët mbi artin, shkembimet e librave, disqeve, numrave të telefonit, fotografitë me njëri-tjetrin ishin lajtmotivi i kësaj mbrëmjeje. Tirana, Tuzi, Kosova, Maqedonia, Shkodra rreth një tryeze, rreth një identiteti, rreth një flamuri me përfaqësuesit e tyre dhe mbi të gjitha rreth bijës së tyre dhe nënës së gjithë botës, reth NËNË TEREZES. U shpërndamë nga ky aktivitet vetm fizikisht, por duke e ndjerë veten më pranë njëri-tjetrit gjithnjë. Një LUMTURIM sjellë gjithnjë LUMTURI.



# “Lufta kundër harresës” e autorit Asllan Krasniqit



**Prof. Rexhep Abazi, Medvegjë.**

Në fshatin Kukuj të komunës së Prishtinës prej 13-19 gusht 2013, në këto ditë vere me vapë të madhe u zhvillua një aktivitet i gjerë kulturor nën emërtimin “Etnofesti 2013”. Ky aktivitet, apo më mire ta quajmë eveniment kulturor, për të tretën herë mbahet në një fshat gadi të lënë në harresë. Falë nismës dhe angazhimit të dy entuziastëve, vëllazërve Hysaj, profesor Fadilit dhe doktor Ilazit, fshatit Kukuj iu kthye një gjallëri deri më tani e paparë për at mjedis të maleve të Gollakut. Ata me ndihmën dhe pëlqimin edhe të familjeve të tyre, kishin bërë një investim jo të vogël, fillimisht në renovimin e objekteve në stilin e kohës së ndërtimit të tyre (shtëpisë së Muhaxhirëve të parë të sanxhakut të Nishit e Prokupjes, më të vjetër se një shekull). Pas kësaj ata kishin filluar nismën e organizimit të Etnofestit, me një tematikë dhe përmbajtje substanciale të kultures shiptare të të gjitha trojeve etnike, duke arritur që në një vend relativisht të vogël dhe në një kohë të shkurtër prej pesë ditësh të mundësojnë paraqitjen e shumë shoqërive dhe grupeve artistike e folklorike nga të gjitha trojet shqiptare, madje edhe nga Medvegja e vogël e Kosovës Lindore (Grupi folklorik “Shpëtimi”).

Aktivitetet u zhvilluan nën moderimin e njerëzve kompetentë të kultures e të

fushave të tjera, me angazhimin e palodhur të z. Ismet Krasniqit-Lalës, i cili nuk diti të ndalej duke pritur e përcjellur grupet e pjesmarrësit dhe paraqitjen e tyre.

S’do mend se këtë eveniment të madh kulturor e begatoi edhe një Ekspozitë e rëndësishme nga e kaluara e popullit shiptar, e paraqitur nga autori me experiencë shumëvjeçare në punën me foto-



grafi, zotëri Asllan Krasniqi, bir i këtyre maleve dhe shkrepeve, nga Tugjeci, aktualisht mërgimtar në Belgjikë.

Ishte kjo ekspozita e shpalosur në ambijentin e hapur të fshatit pitoresk i cili po rilindë në Malësinë e Gollakut me meritën e veçantë të vëllazërve Hysaj, e që mbante titullin simbolik dhe emblemantik “Lufta kundër harresës-EXODI 1999”

Ekspozita ngërthente në vedi pesë tërësi:

Largimi i popullatës shqiptare më 1999,

Kampet dhe të plagosurit,

Kthimi në atdhe,

Gjendja e objekteve dhe

Rivarrimi.

Të gjitha këto ti quajmë tërësi, janë histori në vedi, por z. Asllani, si një mjeshtër i fotografisë, me të cilën shoqërohet më

ceu nga ku qe fshehur - te këmbët e ndjekësve të tij u zgjati kyçet e duarve dhe ata i vunë pranga.

Ndërsa kufitarët e qëllonin ngado duke e sharë në gjuhën shqipe, ai ... qeshte ... qeshte ... vetëm qeshte si një përbindësh me gojë të llahtarshme dhe ata u stepën.

Ai nuk qeshi më. U tha: Isha të serbët! Kam kaluar para hundëve tuaj e të qënve dhe shko-va te serbët ... S’i ngrija dot para serbëve lart këto dy duar që ua shtriva ju; s’i përkulja dot këto gjunjë para palave dhe hymnit të flamurit serb.

U ktheva te prangat e skëterrës që e urrej për vdekje. U ktheva te prangat që kanë mbërthyer atdheun tim, bëni ç’të doni me mua. Ju nuk më kapnit kurr! Dhe pa nga flamuri shqiptar që valavitej mbi postë. Ishte ende errësirë por jo aq sa kufitarët shqiptarë të mos dallonin mbi palat e flamurit lotët e burrit që erdhi t’i shtrinte duart prangave.

Në brezin e pilotit të rriturit në shtëpinë e fëmijës, ja, qenë thyer dy djem shqipërie. Aristotel P. dhe Ilija K. Ata vendosën të mos ktheheshin më tokën që i kishte lindur por, në planin e tyre të braktisjes, ata kishin parashikuar edhe një masë që rrallë mund t’i binte ndër mënd ndonjërit nga djemtë e hedhur dhe me gjellët pa kapak - të fshiheshin sa më larg.

Kur Ndue Logu vetë i 18 udhëtonte për në atdhe me zemër të mbushur dhe të thyer për Aristotelin dhe Ilian, një grup tjetër djemsh shqiptarë që do të kthehej pas tyre, po bridhnin nëpër rrugët e qytetit me thika të fshehura. “Ishim gjashtë veta. Ishim në grup. Nëse do të hasnim kund njërin apo të dy nga dezertorët, secili do të hante në një kohë 6 të ngulura thike në emër të atdheut dhe popullit që kishin braktisur” – më tha njëri prej ekzeku-

torëve të mundëshëm.

Burri ka kohë për t’u turpëruar edhe në rini, edhe në burrëri, edhe në pleqëri. Dezertori ka vetëm një emër; është një cilësi që bashkon si me një komandë karaktere, ngarje, periudha historike dhe rrethana gjithfarëshe. Ndue Logu u ngrit si një lapidar prej mali në burrërinë e tij.

Unë nuk di ndonjë pilot tjetër, që populli t’i ketë kënduar një këngë kaq të veçantë dhe në një rrethanë kaq të veçantë, siç ka qënë njëra e krijuar gjatë ndërmarrjes mbarëpopullore për elektrifikimin të plotë të vëndit. Pas vrasjes në aksionin e rinisë së një vajze prej Dukagjinit, quajtur Shkurte, pas kësaj nxitjeje mbarëpopullore, nisën të ndizeshin drita edhe në zona ku kishin jetuar prej mijëra vjetësh me kandil, bishtukë a pishë të ndezur.

“Llampa e ndezur shfaqej në çdo shtëpi si fytyra e Shkurtes”, shkruante një poet nga më të njohurit e asaj kohe. Elektrifikimi i Dukagjinit, kësaj monade shqiptare, ka qënë një punë e bërë me hare të paparë dhe në mënyrë të jashtëpërfytyrueshme, duke shfrytëzuar energjitë e pashterrëshme që gjeneron një shpirt i rënë në dashuri. Pilotët bënë çudira në atë kohë për të aritur që të ndizej drita mes dhomës si “fytyra e Shkurtes”. Dhe, populli i këndoi Ndue Logut një këngë, kështu: “Paj, kush ishte, more njaj piloti? 7 Bash Ndue Logu, nji djalë prej Shoshi”.

Ndue Logu doli i paaftë nga një sëmundje profesionale pilotësh – “lumbago”. Por ai, në kohën e indondateve të dëborës nuk linte fluturim pa shkruar duke fluturuar përmbi borë drejt zonave veriore e verilindore në atë dimër të ’85. Ani, si pasagjer rrinte, ama, ky njohës i mrekullueshëm i terrenit, ndihmonte pashpesh ekipazhet, megjithëse ... tanimë mund

19 gusht 2013. Përndryshe e tëra u kush-tohej vuajtjeve shqiptare, me moton: Lufta kundër harresës, 50 vjetë rrugëtim në kërkim të fotografisë 1963-2013.

Autori i Ekspozitës, z. Asllan Krasniqi, nga Tugjeci edhe në vitin e kaluar me ftësën e Ministrisë së Diasporës kishte organizuar 5 ekspozita (4 në Kosovë e një në Shqipëri), ndërsa në këtë vit të njëjtën ekspozitë e shpalosi në dy vende të Gollakut, në Tugjec dhe në Kukaj.

Z. Krasniqi tha se rregullisht ekspozon në Belgjikë-Bruksel në një konkurrencë të ashpër me krijuesit me renome botërore, siç është ajo në Bruksel prej 23 qershorit – 15 shtator 2013, ku marrin pjesë afër 50 artist me veprat e tyre të pikturës, skulpturës e të tj. në të cilën ky është i vetmi fotograf me fotot e tij dhe e cila ka një numër shumë të madhë vizitorësh dhe adhurues të artit. Pastaj ekspozita me rastin e formimit të shoqatës për bashkim komëtar “Jemi NJË” pokështu në Bruksel e tj.

Duhet cekur në veçanti siç na tha z. Krasniqi se për të Ekspozuar në Tugjec dhe në Kukaj kishte ardhur enkas nga Belgjika, që nuk ishte edhe aq e lehtë.

Por, njëkohësisht z. Krasniqi shprehu një brengë që kjo ekspozitë e organizuar me një mund dhe sakrificë, pak gjeti vend në mjetet e informimit, me siguri jo me qëllim, por ndoshta do të ishte mirë do të kishin mundësi të mësojnë më shumë njerëz për te, sikur ti jepej një vend i duhur edhe në mjetet e informimit.

Në fund z. Asllan Krasniqi falënderon të gjithë vizitorët e ekspozitës së tij, organizatorët e Etnofestit, Ministrinë e diasporës dhe të gjithë ata që bënë të mundur mbajtjen e këtij eventi me vlera kombëtare e kulturore, veçanërisht vëllazërit Hysaj.

të rrinte në një depo, zyrë, me një reflektor te këmbët, se ishte “shef armatmi”.

Në një periudhë u bë bujë e madhe, e jashtëzakonëshme – Shqipëria e perçeve të dikurëshme, e gjakmarrjeve të dikurëshme, e dhunës ndaj gruas shënoi një ngjarje që është përsëritur vetëm një herë. Kater vajza të Institutit të Kulturës Fizike, pikërisht Flora Toto, Polikseni Vjeshta, Drane Cara dhe Vezire Meta, u hodhën që nga qielli mbi Tiranë me parashutë. Parashutisti që i hodhi vajzat ka qënë shefi i kësaj arme, pionieri i parashutizmit shqiptar, Shaban Danaj.

Po piloti që i hodhi, cili qe? Ndue Logu, që u varros me 14 shtator 1986.

Mbase ... mbase, përveç bustit të heroizimit të tij të ngritur nëpër zemrat e atyre që e njohën, në emër të kontibuteve të tija për ushtrinë shqiptare, artin e fluturimit, devocionit për kryerjen e detryrave ajrore por, sidomos, për planzhonin e tij të fundit drejt vdekjes në emër të jetës së të tjerëve, do të ishte gjëja më normale dhe në përputhjen me aliazhin e artë të traditës sonë te vjetër dhe të botës moderne ushtarake, që Ndue Logu, ta kishte një bust.

Një bust në mes të repartit ku ai dha jetën, apo në Shosh, në Shkodër, në shtëpinë e fëmijës apo në ndonjë rrugë të Tiranës ...

Përfunduar ora 06.00 e mëngjesit, me date 15 prill 2013.

Ps

Kjo pjesë rënqethëse që sapo lexuat nuk do të ishte shkruar kurrë nga dora ime, pa kontributin, shtyrjen, nxitjen, këmbënguljen dhe pasionin deri në përgjërime të pilotit Niaz Ne-laj, nga Kalivaçi i Tepelenës, ish shkruesi i historisë së këtij regjimenti.

Gjin Musa

## SHKELËSI I KUFIRIT

Ai ishte njohësi i mrekullueshëm i terrenit dhe qenve. E urrente komunizmin, rronte si në skëterrë dhe vendosi të arratisë. Kur ishte pesëqind metro larg piramidës, u dha alarmi.

Kufitarët u sulën me qën dhe me kallashë duke krehur vëndin. Ai qeshte dhe lozte me ta si macja me miun. Kufitarët, nuk e kapnin dot dhelpërën që i qesëndiste nëpër labirinthe e saja; i ngacmonte, suleshin ta kapnin, u humbiste si një fantazëm dhe u hidhte një gur nga cepi tjetër e fshihej paq sërish.

Një qën iu afrua fare pranë njohësit të mrekullueshëm të botës së qenve. Në zonën neutrale, shtiu lart dhe u fsheh si të qe rritur ndër pyje.

Kaloi piramidën - “R. S. F. e Jugosllavisë” - e hodhi automatikun përtej ... Kishte mbërritur në Botën e Lirë, tanimë nuk ishte më në skëterrën me komunistë, që donte t’i piqte të gjallë.

Kur ndjeu të flisnin serbisht në vënd që të ngrinte duart, u fsheh. Ndjeu ta shanin “mysafirin” e kësaj nate, atë, “Jeben ti majka!” Paskam kaluar nga skëterra komuniste për të ardhur në duar të serbëve?

Nëna ime! - Klithi pa zë njohësi i mrekullueshëm i botës pyjore dhe qenve, ndërsa ushtarët po e kërkonin duke bërëtitur serbisht. Si klithi dhe një herë për të emën, u kthye andej nga kish ardhur. Kur kaloi piramidën shqiptare e kuptoi se ishte e pamundur të fshihej më.

Kur u siguroa që pas pak do ta kapnin kë-



PERSHENDETJA E PRESIDENTIT TE UNIONIT ARTISTIK NACIONAL, AZGAN HAKLAJ, NE VEPRIMTARINE KUSHTUAR 10 VJEORIT TE LUMTUNIMIT TE NENE TEREZES

## Azgan Haklaj: Nënë Tereza, engjëlli shqiptar që me dashuri pushtoi qiejt



Më 16 tetor 1979, kur bota u lajmërua, jo pa sensacion, se një misionare në Kalkutë do të merrte çmimin *Nobel*, biografë e gazetarë u turrën të rrëmonin në biografinë e kësaj gruaje të brishtë e të çuditshme. Fjalëpak, por e saktë dhe e vendosur në atë që thoshte, ajo iu përgjigj medias botërore: "Nga gjaku dhe prejardhja jam shqiptare. Kam shtetësi indiane. Jam murgeshë katolike. Nga prirja i përkas gjithë botës... Me zemër, i përkas plotësisht zemrës së Jezusit".

Ishte Nënë Tereza, që si rrufe në qiell shndriu mbi errësirën që asokohe kishte kapluar Shqipërinë, vendin e izoluar e të harruar të shqiponjave. Dhe ja, kjo grua e vogël na e rikthen edhe njëherë si komb atë emër të madh që patëm latuar në shekuj me perandorin Konstandin apo me Skënderbeun. "Një grua vërtet e vogël me trup, por që s'ka asgjë të vogël në qenien e saj" – do ta përshkruante Indira Gandhi.

Nga madhështia e dashuria e saj, ajo do t'i jepte gjithë globit nga Kalkuta në Irlandë, nga Venezuela në SHBA, por dhe vendit tonë do t'i dhuronte më shumë nga të gjithë: qenien e gjakut që i rridhte në damarë, atë shqiptar. Ne ishim kombi i braktisur nga njerëzia, liria dhe nga Zoti. Ishim kombi i dënuar të përjetonim copëtimin e robnimit kush prej sistemeve ekstratotalitare e kush prej dhunës shovene. Dhe ja, një fat në buzëvarur, një qiri shkëlqimtar që ndriçonte fundin e tunelit të destinin fatal shqiptar: Nënë Tereza. Ajo me dy fjalë për origjinën e saj arbënore e me një foto të vitit 1925, kur s'i kishte mbushur të pesëmbëdhjetat, veshur me rrobën tradicionale kombëtare shqiptare, po i thoshte botës se shqiptarët jo vetëm ekzistojnë, por janë në vëmendjen e vetë Zotit. Një befasie e mrekullueshme që bëri Papën, mbretërit, presidentët e fuqishëm të globit të kujtoheshin një çast, se aty buzë Adriatikut, rrethuar me tela e të izoluar prej perëndimit, që prej lashtësisë, jetojnë shqiptarët e Nënë Terezës e të Gjergj Kastriotit. Prej asaj kohe kanë kaluar dekada e kombi ynë ka galopuar drejt së mirës e fatit më shumë se çdo komb në fundshekullin që lamë pas e në këtë që po jetojmë. Por nuk mund të mohohet se pa zë e me modesti, pa zhurmë, por me shumë përkushtim e dashuri, ne kishim me vete si melhem e hajmali, si bekim e afrim te Zoti, dorën dhe mendjen e Nënë Terezës. Se vetë Nënë Tereza

ishite një laps në dorën e Zotit, me të cilën duket se Perëndia nënshkroi për të na e ndërruar fatin e larguar, për të na i zbuar, më në fund, ndëshkimet dhe mallkimet



shekullore.

Edhe sot, kur ne shkojmë në Bruksel për të konsultuar obligimet tona integrale, më shumë se gjithçka ajo që na lidh me Perëndimin, me Zotin e qytetërimin është natyrisht edhe vegimi e emri i madh i Nënë Terezës. Kjo grua gjeni, jo vetëm e besimit, e bamirësisë, është dhe esenca e një filozofie të re, e cila u kyç jo pa rëndësi e pa efekt në epokën e globalizimit. Kur paraja po synonte të konkurronte vetë Zotin, Nënë Tereza këshillonte të pasurit të mos gëzoheshin dhe aq, kur në botë miliona njerëz vuajnë urinë, sëmundjen, luftën. Ajo i kërkoi botës humane jo lëmshë e mëshirë, por besim e afrim te Zoti, mirësjellje e dashuri njerëzore.

"Më mirë të bëni gabime me mirësjellje, sesa mrekulli me vrazhdësi." Kjo thën-

ie biblike e Nënë Terezës është kthyer në sloganin e të gjithë shpirtëve njerëzorë që besojnë te Krijuesi.

Gjenia e Nënë Terezës, mrekullia e saj, nuk qëndron vetëm në shërbimet e saj e të Urdhrit të vet shpërndarë në të gjithë botën, në të mirë të të sëmurve, të të varfërve e të uriturve. Është shumë më gjeniale dhe hyjnore. Ajo i argumentoi njerëzimit se vuajtja për dashuri dhe uria për të është më e rëndë se uria për bukë. "Po të kishte të uritur në Hënë, unë do të shkoja dhe atje..." Kështu e përshkruan përkushtimin një ftesë për këdo dhe kurdoherë drejt një qëllimi të mirë, human e fisnik", sepse fisnike ishte vetë Nënë Tereza, gjaku e gjeni i saj shqiptar.

34 vite nga laurimi i saj me *Nobel* dhe 10 vite nga lumturimi, mbushen pas disa ditësh. Bota ka filluar të festojë e të kujtojë këtë engjëll të brishtë që e lindi, e rriti nëna e toka shqiptare, për t'ua falur qiejve, nga ku ajo të mund të vijojë përjetësisht misionin e saj hyjnor. Ajo qëndron lart mbi ne, e mbështjellë me rrobën ngjyrë qielli e reshë të bardha, duke na vëzhguar e duke u lutur për ne. Duke u lutur për të gjithë, pa na ndarë as në fe, as në ide. Le ta dëgjojmë këtë lutje engjëllore, se aty mëshirohet dhe shqip, se shqiptare qëlloi jo rastësisht, të ishte aty ky engjëll unik që Zoti ia dhuroi njerëzimit ...!

## Me Azem Hajdarin në Shiroke ditën e Shën Rrokut, me 16 gusht 1991

Me 16 gusht 1991 në Shiroke ishte hera e pare mbas ramjes së komunizmit, që festohej nga katoliket e qytetit dhe të rrethinave të Shkodrës festa tradicionale shume shekullore e Shna Rrokut. Shna

Rroku asht pajtori i fshatit të peshkatarëve të Shirokës, buze Liqenit të Shkodrës, ku besimtarët atë dite organizuan procesionin tradicional me këngë të përshpirtshme rreth Kishës kushtue këtij shenjt, së cilës sot i shërbejnë rregulltarët orionine.

Me këtë rast, imzot Zef Simoni (1928-2009) tha meshën dhe drejtoi procesionin e besimtarëve katolike që filloi nga Kisha e rreth e përfaqësojë të Shirokës, ku veç shirokasve e ndoqën mija shkodrane dhe banor të katundeve për rreth. Me këtë rast kishin ardhë edhe shume familje zadrimore dhe gratë zadrimore ishin të veshuna me rrobe tradicionale zadrimore të papërzieme nga influencat e pushtuesve të huej. Gjate meshës, imzot Zef Simoni në predikimin e Tij bani edhe një përmbledhje të vuetjeve dhe të persekutimeve të popullit shqiptar dhe në veçanti të komunitetit katolik nga regjimi i diktaturës komuniste. Ky predikim emocionoi të gjithë të pranishmit, katolik e jo katolik, sepse ishte nder herët e para që nga një prift ish i burgosun katolik, të flitej publikisht në popull mbi këto persekutime. Deri në ato muej, mbas diktaturës populli ishte ende si i mpimë dhe i friksuem nga terrori komunist i 45 viteve diktature te tmerrshme. Populli e ndoqi me shume devocion këtë procesion që bahej



Në Shiroke (Shkodër) me 16 gusht 1991, dita që për të parën here mbas ramjes së komunizmit u festua në Shiroke dita e Shna Rrokut. (Në realitet e pare sipër: i pesti Azem Hajdari, i gjatshi Paul Tedeschi. Kjo foto publikohet për të parën here)

për të parën here në Shiroke mbas ramjes së komunizmit dhe të ndërpreme që nga viti 1966 kur u ndaluen me ligje ritet fetare në Shqipni.

Historia e Shën Rrokut (1346-1380) është sa e veçante aq edhe e dhimbshme. Katoliket në të gjithë botën e nderojnë Shën Rrokun. Ai asht shenjt i cilit i

kushtohen më shume kisha e kapela se asnjë tjetri. Biografët e tij të hershem tregojnë se, pas vdekjes së prindërve ai u shpërndau pasurinë që kishte të varfërve dhe u nis si shtegtar drejt Romes. Rugës për në Rome, ai mbërriti të shëronte të gjithë të sëmurët me murtaje të zeze. Asokohe, murtaja e zeze kishte mbytur një të tretën e popullsisë



# cikël me poezi ...Lulash Brigja

## NUK E DI ...???

Nuk e di sa vite kam  
se jetën e mati krejt ndryshe ...  
dhimbjet i pjesëtojt me katër ...  
e gëzimet i shumëzot me dy ...

Një kujtim i keq ...  
një vit jetë ta shkatërron ..  
.gëzimi, sukcesi, dashuria  
Të mban gjalle të rinon

Buzëqeshja më duket si flutur  
mërzia më duket si qyqe  
ah kam lindur me defekt  
e jetën e mati ndryshe

Nuk e di sa vite kam  
por e di se duhet të jetoj  
më duket kam mësuar të eci  
por kam harruar të vrapoj ...???

Vitet ecin ..., ecin  
e kuptoj edhe vete ....???  
por nuk po e kuptoj  
çfarë është jeta ...???  
mashtim apo e vërtet ...

## NËSE S' KE KOHE ...???

Nëse s'ke kohe  
të mi shkruash dy rreshta  
Kur bota është e mbushur  
plot me fjalë  
Atëherë më nis një mesazh bosh  
që sytë e tu ... ta kenë pare

Nëse s'ke kohe ...  
për një kafe  
Se rrugët e jetës ...  
rrallë na takojnë ... ???  
Të paktën më dërgo një zile  
Kur lemza të ... të ngacmojnë ...???

Nëse s'ke kohë  
për të më kujtuar  
se ditën e ke të mbushur me punë  
Të paktën bëje një - aaaaaahh ... ???

tek krevati ...!  
se pastaj ... poezinë e vazhdoj unë ???

Nëse s'ke kohë ....  
këtë jetë për mua ....???  
Mos më kërk kur te kem vdekur ...!!!  
Të lutem ... mos qaj  
... mbi imazhin tim ...  
Që gabimisht tek ti ka mbetur ...???

Për vete dhe për ju ...  
Kur njerëzimin e mbërtheu kriza  
dhe tokën e kërcënoj  
ngrohja globale ...  
unë ngarkova një çante  
me ëndrra dhe kujtime  
e u ngjita ... lart në male ...



Derën e kullës e gjeta pa dry ...  
ajo u hap vetë ...  
nuk pata nevojë me e shty.  
Në oxhak një cung i madh  
gjysma dru e gjysma hi ...?  
Folën muret me mua ...  
apo fola unë me vete, Se di ...!!!

Cep në cep fshatit i rashe ....  
e zog as rob nuk pashe ...?  
Veç zhurma e kroit që ishte mbulua me  
ferra ...  
dhe krisma e dardhave ...  
që i rrëzonte era ...?

U ngjita lart në bjeshke ...  
tek mrizi i madh shekullore ...  
Eh .... u kënaqa ...

Mu duk se ... u rrita një pëllëmbë  
Mu duk se qiellin e preka me dore ... !!!

Shkova tek një gështenje e bashku  
që dikur me kapuç e kanë  
nda ...??  
fjeta në një konak të vjetër  
se isha lodh, e nata ra ...

Nuk e di se kur fjeta ,  
nuk e di as kur jam çua  
Por e di se ..??  
... nuk kam lanë gjë pa thanë  
... PËR VETE, DHE PËR JU ...?

## KE ZEMER TË VOGËL....???

Ah sa shumë u mundova  
të hy në zemrën tënde .  
Por nuk hyra dot ...  
Atë kohe u mërzita ...

ama nuk jam bërë pishman  
as dje as sot ,,,!!!

Ah sa shumë trokita ...  
në dritaren e ëndrrave tuja  
pran saj më gjeti hëna ...  
e aty më zbardhi dita ...???

U zvogëlova, u kërrusa  
por dritarja e zemrës tënde  
... ishte e vogël,  
e unë u rrita ...!!!

Të prita, ...  
të prita shumë  
por zemra jote mbeti po ajo ...  
Unë nuk rrija dot  
gjithë jetën shtrëngueshëm  
më beso ...???

Kur ti lexosh këto vargje ...  
mos kërk fajtor  
mos u zemëro ...  
e sytë me lot mos i

mbush ...  
Ke zemër të vogël mike ...???  
aty s'mund te jetoj  
askush ...!!!

## SHKODËR-LOCE KE PRITE TRIMA

*Kujtesë, në prak të festave të mëdha*

Ç'po zverdhonjë fushat nga çallmat  
Ç' u nxi Qielli e u nxi toka  
Djem't e Shkodrës ç'veshin pallat  
Nuk na trembe turku me topa.

Shtrëngon dhambet Pashaj n'Kala  
Shpejt n'Stamboll niset haberi  
M'qe Sulltan asqerë pa pra  
Se ç'farosi Dasho Shkreli.

Shkon n' Vranine tymi përpjetë  
Ç' po luftojnë burrat si motit  
Oso Kuka-trim me flete  
-Digjet flake ne kulle t'barotit.

Nji kolos që dridhi token  
Pushka as fjala kurrë si huqi  
N' kambe e ngriti mbare Evropën  
Trimi-Luigj Gurakuqi.

Vojo Kushin e Vasil Shanton  
l'pat' linde Shkodra-dragoi  
Me Manushin, Jordanin, Brankon  
Me Ndoc Mazin e të tjerë heroi.

Alimani trim i trimit  
Por si Krishti n' kryq gozhdue  
Nen torturat e Hansdingut  
Burrnisht diti me qendre.

Tek ti rrajte i ka trinia  
Shkodra Loce-Gjeraqine  
Do t' shkëlqejë për jete Lavdia  
Për t' gjithë brezat që do të vijnë.

**Mark Bregu**

P.S. Marrëdhëniet shume te mira qe kemi  
ndertue me shtetin Turk, dhe me shtetin  
Italian, nuk munde të shlyejnë nga ku-  
jtesa e çdo qytetari luftën pese shekul-  
lore ndaj Perandorisë Osmane dhe luftën  
kundër pushtimit fashist.  
Uroj që në këtë përvjetor të knohen  
kangët, tashme të harrueme: "Gryke e  
Kaçanikut"  
Dhe "Xhamadani i trimnise", "Dasho  
Shkreli" dhe "Dede Gjon Luli".

së Evropës. Legjenda tregon se, Shën Rroku ka qene edhe në Shqipëri, në Shiroke, e këtu është ruajtur deri vonë një peme mani, e cila rridhte prej pemës që vete shenjt, sipas rrëfimit legjendar, kishte mbjelle dikur! Por fatkeqësisht të dhënat historike për vizitën e tij mungojnë. Vdekja e tij do të ishte e dhimbshme, kur në 1380 vdes i harruar nga të gjithë, pasi e ngatërruan me një spiun të kërkuar nga policia dhe e flaken në burg për 5 vite.

Me këtë rast kishte ardhë në Shiroke edhe një nder përfaqësuesit e randësishëm të Partisë Demokratike, Azem Hajdari (1963-1998). Prezenca e tij atë dite ishte një mbështetje që i bahej komunitetit

katolik dhe në përgjithësi popullsisë së rrethit të Shkodrës për Lirinë e Besimit dhe Liritë Demokratike. Azem Hajdari takoi shume shkodrane demokrat, korrespondente të gazetave të ndryshme si dhe shume iniciator të zhvillimit të proceseve të demokratizimit të shoqnise shkodrane dhe të shoqnise shqiptare në përgjithësi.

### Mbas vitit 1991

Mbas këtij viti 1991 në Shqipni ndodhen disa transformime të matejshme në demokratizimin e shoqnise shqiptare, por edhe në devijimin e rrugës së propaganduesit Partisë Demokratike, Sali Berisha "Do ta bajme Shqipnine si Evropa!" apo "Do ta çojmë Shqipnine në Evropë!"

Në një të diele të muezit maj të vitit 1991, Sali Berisha bani në teatrin "Migjeni", në Shkodër një takim me shkodranet antikomunist, liridashës dhe demokrat. Gjate këtij takimi, Sali Berisha nder të tjera preku edhe përcaktimin e rrugës së shkuemjes drejte Evropës si dhe njikohesishme të përforcimit të marrëdhënieve të Shqipnise me vendet afro-aziatike. Disa pyetjeve të ndigjuesve rreth këtyne dy temave të rëndësishme, Sali Berisha nuk ishte në gjendje tu japë përgjigje të sakta dhe të qarta, por dha disa përgjigje evazive. Me këtë, ai tregoi para popullit të pjekun shkodrane falsitetin e parrudhave të tij propagandistike si dhe mosnjohjen e lidhjeve shekullore të Shkodrës dhe të

shqiptareve me Evropën dhe qytetimin evropian. Fill, një vit mbrapa, në vitin 1992, Sali Berisha pa pyet as Qeverinë, as ministrat, as Kuvendin shqiptar dhe as mendimin e popullit shqiptar e futi Shqipnine në Konferencën e Vendeve Islamike me shumice afro-aziatike, nder kohe që Shqipnia nuk asht fute ende, as sot në Bashkimin Evropian. Ky fakt u pasue me vërshimin në Shqipni të elementëve të dyshimte arabo-islamike, me të cilat iu deshtë të merrej shteti shqiptar, shërbimet sekrete shqiptare dhe gjykatat shqiptare. Mbas disa viteve u vrà Azem Hajdari, vrasje që as sot nuk asht zbardhe plotësisht.

*Paul Tedeschini*



# NJOFTIM

**Me datën 6 tetor 2013, u mbledh Këshilli i Shoqatës dhe mori këto vendime:**

**1 Perberja e kryesise se Keshillit te Shoqates:**

- \* Prele Shytani, në detyrën e Kryetarit të Këshillit të Shoqatës,
- \* Ndoj Mhilli, në detyrën e N/kryetarit të Këshillit të Shoqatës
- \* Aleks Dushi, në detyrën e Sekretarit të Këshillit për çështje organizative
- \* Anton Kosteri, në detyrën e Sekretarit të Këshillit për çështje juridike.

**2 Perberja e anëtarëve të kryesisë:**

- \* Gjergj Leqeja,
- \* Luigj Shyti
- \* Lazer Kodra,
- \* Prele Milani,
- \* Roza Pjetri,
- \* Angjelina Shllaku,
- \* Mhill Prioni,
- \* Dukate Bregu,

**3 Planin e Veprimtarive për periudhën tetor 2013-tetor 2014**

\* Vijimi i botimit të gazetës "Dukagjini" në çdo muaj dhe në muajin mars 2014, të bëhen përpjekje të dalë me 16 faqe.

\*Të marren masa për të përkujtuar 100 vjetorin e rezistencës së Dukagjinit kundër ushtrive malazeze dhe 100 vjetorit të vrasjes së Mehmet Shpendit, si dhe të 90 vjetorit të lindjes së Martin Camaj, duke bere përpjekje për ngritjen e monumenteve për këta kolos të Dukagjinit, muaji korrik 1915.

Ne ketë periudhe te behën përpjekjet për miratimin e ngritjes se këtyre monumenteve, miratimi i shesheve te vendosjes se tyre nga Këshilli i Bashkisë Shkodër dhe fillimi i punës.

\*Të përgatiten e zhvillohen zgjedhjet në baze dege dhe të ndërrohet dokumenti i anëtarësisë brenda muajit dhjetor 2013

Për degën Shkodër, Luigj Shyti e Dukate Bregu

Për degën Tirane, Ndue Sanaj e Lazer Kodra

Për degën Kurbin, Mhill Prioni e Roza Pjetri

Për degën Lezhe dhe Malesi e Madhe, Prele Milani e Angjelina Shllaku

Të komunikoni me kryetaret e degëve dhe deri me datën 25 tetor 2013, të jepni datat e mbledhjeve të degëve.

\*Të bëhen përpjekje për përgatitjen dhe dhënien e 2 emisione televizive për kontribute të Dukagjinit e dukagjinase në shekuj. (Në mars 2014 dhe në shtator 2014)

Seksioni i veprimtarive te historiografisë dhe te kulturës popullore dhe i marrëdhënieve me publikun e me jashtë.

\* Të botohen deri dy libra deri ne muajin gusht 2014

\* Te përgatitet e zhvillohet një ekskurSION me rininë, në periudhën korrik-gusht 2014

\* Të përgatitet dhe zhvillohet një koncert folklorik në teatrin "Migjeni", në muajin dhjetor 2014 ...

\* Të përgatiten dhe zhvillohen ceremoni për paraqitjeve të librave të rinj. (Në qoftë se do të ketë libra të rinj. ...

\* Të bëhen përpjekje të hapet zyra

turistike për informacion dhe drejtim e shoqatës në Shkodër brenda vitit 2014.

**4 Projekt-buxheti per periudhen tetor 2013-tetor 2014**

Emërtimi i veprimtarive	Shuma ne një vit
Botimi i gazetës	324 000
Botim libri, një 300 kopje	220 000
Veprimtari përkujtimore	70 000
Paraqitje libri	105 000
Marrja pjese ne manifestimin "Zëri i Vëllazërimit"	120 000
Zyra e shoqatës, ajo dhe për turizëm, qiraja për një vit	884 000
Veprimtari përkujtimore me 100 vjetorin e Rezistencës së Dukagjinit kundër ushtrive malazeze, të 100 vjetorit të rënies së Mehmet Shpendit, dhe të 90 vjetorit të lindjes së Martin Camaj. Ngritja e monumentit të Mehmet Shpendit dhe Martin Camaj në Shkodër	200 000
Emisione televizive	120 000
EkskurSION me rininë	50 000
<b>Shuma</b>	<b>2 093 000</b>

**b) Me datën 14 tetor 2013, Kryesia e Shoqates, mori keto vendime:**

**1 Emerimet e perberjes se kryesise se Shoqates:**

- \* Gjergj Leqeja, ne detyren e Nënkryetarit të Kryesisë,
- \* Luigj Shyti, ne detyren e Sekretarit te Kryesise,
- \* Lazer Kodra, ne detyren e Kryeredaktorit te gazetes "Dukagjini",
- \* Prele Milani, ne detyren e Kryetarit te seksionit te Historiografise dhe Kulture Popullore,
- \* Roza Pjetri, ne detyren e Kryetares se seksionit te veprimtarive Kulturore e Artistike,
- \* Angjelina Shllaku, ne detyren e kryetares se seksionit te Gruas e Rinise,
- \* Mhill Prioni, ne detyren e kryetarit te seksionit te Ekonomise e Finances.

\* Dukate Bregu, ne detyren e kryetares se seksionit te Marrëdhënieve me Publikun e me Jashte,

**2 Perberja e seksioneve te keshillit dhe kryesise se Shoqates:**

- \* Redaksia e gazetës, të përbëhet nga 7 anëtare:  
Lazer Kodra  
Prele Milani, për historiografinë dhe kulturën popullore  
Lazer Kodra e Ndoj Mhilli për letërsinë  
Roza Pjetri e Lulash Brigja për veprimtaritë kulturore e artistike  
Zef Gjeta, për veprimtari te ndryshme  
Altin Nika
- \*Seksioni i Historiografisë dhe i kulturës popullore, të përbëhet nga 5 anëtare:  
Prele Milani  
Aleks Dushi  
Ndue Vata  
Tringa Rapi  
Ndue Marashi
- \*Seksioni i veprimtarive kulturore e artistike, të përbëhet nga 9 anëtarë:  
Roza Pjetri  
Tomir Delija  
Armair Grima  
Silvana Arrinaj

Augustin Pëllumbaj

Gege Shpataj

Pëllumb Vrinca

Gjok Arra

Diana Bungu

\*Seksioni i Gruas dhe i Rinise, të përbëhet nga 5 anëtarë:

Angelina Shllaku

Edita Ferluskaj

Luigj Ujka

Renato Lumçi

Donika Malaj

\*Seksioni i ekonomisë dhe i financës, të përbëhet nga 7 anëtarë:

Mhill Prioni

Agron Hasanaj

Miri Kroj

Kole Çardaku

Dede Vuksani

Pal Lera

Fatmir Vojvoda

\*Seksioni i marrëdhënieve me publikun e me jashtë, të përbëhet nga 5 anëtarë:

Dukate Bregu

Hana Rrgalla

Nike Kodra

Mirsada Lumçi

Altin Nika

**Disa përfundime nga Mbledhja e Këshillit dhe të Kryesisë së Shoqatës, nga Kryetari i Saj, Ndue Sanaj**

\* Konferenca V e Shoqatës, na ka nderuar duke na zgjedhe në strukturat e saj drejtuese. Vërtetë, që na ka besuar, dhe kjo është nder, por na ka futur edhe në pune dhe puna që do të bëjmë është fisnikëri se, jo vetëm do të punojmë me përkushtim për të realizuar misionin e Shoqatës, por do të punojmë pa shpërbllim, do të punojmë vullnetarisht dhe këtu qëndron fisnikëria e punës sonë, këtu është sekret i arrietjeve tona në këto 10 vjet dhe duhet të jete edhe në të ardhmen.

\* Gandi i Indisë, theksonte: "Bëhu ti ndryshimi që dëshiron të shohësh tek bota, ...". Ndryshimin, sigurisht nuk pretendojmë ta bëjmë te bota, por jo me kote, Mehmet Shpendi dikur i thoshte Edith Durhamit: "... Shala është qendra e botes ...", me të cilën themi se, ndryshimin ta bëjmë dhe ta shohim te Dukagjini, te dukagjinasi, por pa ndryshuar vetveten, nuk mund të pretendojmë më tej. Prandaj, Kryesia e "vjetër" e Shoqatës, në eksperiencën e saj, arsyetoi që të bëjmë këto ndryshime statusor, duke krijuar Këshillin e Shoqatës, si një strukturë vendimmarrëse me vete duke qene pjese e së tërës, sepse kohet e fundit patëm ardhje të reja në Shoqate, të cilat kane arsimin e larte, kane eksperiencën e nevojshme në pune të ndryshme në marrëdhënie me njerëzit, në marrëdhënie me shoqërinë civile, të cilat na duhen për të ecur më tej, për të cilat kemi nevojë për ketë eksperience, kemi nevojë për ketë gjak të ri për të ecur më mire, për të ecur më me kulture në realizimin e misionit të shoqatës. Këta të rinj dhe ata që kane dhënë kontribute 10 vjeçare të jene në simbioze njëra me tjetrën, për të punuar më mire.

\* Presidenti Amerikan, John Kkenedi, theksonte: "Një njeri mund të vdesë, edhe kombet lindin e shuhën, por një ide e mirë jeton përgjithmonë ...". Me ketë aforizëm të Kenedit, duam të themi: Ne, kur

themeluam ketë shoqate, nuk menduam se një dite mund të marrim ato vlera që kemi marre, nuk menduam se ne, mund të mbesim në histori, madje nuk menduam se, do të arrinin deri këtu, por ja që erdhëm, në saj të një përkushtimi dhe vullneti të vendosur në realizimin e idesë, të asaj ideje, që ti shërbejmë Dukagjinit e dukagjinase kudo që ndodhen, në mënyrë të veçante në mjedisin ku jetojnë e punojnë, për tu hapur më shume, që në themel të kësaj hapje të jene vlerat individuale, dhe këto të jene në raport të drejte njëra me tjetrën. Këto dite, profesor doktor Mahir Hoti, në mes të tjerave na thoshte: "Shoqata "Atdhetare-Dukagjini" ka punuar mire dhe ju lumtë! Mjafton, që sot nuk dëgjon më të thuhet: Atë apo ketë të keqe në Shkodër e beri dukagjinasi. Atij i është hequr nofka: "Dukagjinasi sinonimi i së keqes ...!". E kjo nuk është pak, por keni bere ato që strukturat e shtetit nuk i kane marre përsipër ti bëjnë, ndërsa ju i keni bere pa buje, në heshtje ashtu siç ka punuar kurdoherë dukagjinasi ... Edhe një here ju lumtë!". Mendojme se, nuk ka shume nevojë për komente. Por, gjithashtu mendojme se, kemi shume për të bere. Kjo është e vërtetë!

\* Ju, po sa u njohët me vendimet e Konferencës së V të Shoqatës, po sa u njohët me anëtarët e Këshillit të Shoqatës, po sa u njohët me vendimet e Këshillit të Shoqatës, po sa miratuar propozimet e Kryetarit të Shoqatës, po sa u njohët me Planin e Veprimtarive dhe projekt-buxhetin e Shoqatës, për periudhën tetor 2013-tetor 2014! Këto nuk janë thjeshte kureshtje, por janë detyra mjaft ambicioze, janë detyra mjaft fisnike, në veçanti realizimi i planit të veprimtarive se, puna matet me realizime dhe jo me fjale.

Prandaj, gjithsesi për të realizuar këto synime, duhet pasur parasysht:

**Së pari**, vëmendja kryesore duhet të përqendrohet në përgatitjen e realizimin e tyre me kulture. Pra, kryetaret e seksioneve dhe grupet e punës të veçanta duhet të punojnë. Për të punuar, duhet planifikuar, duhet të bëhen projekte, të shoqërohen me preventive dhe duhet ti paraqiten kryesisë për miratim. Pas miratimit, me anëtarët e seksionit të organizojnë punën dhe ti futen asaj për realizim.

Duhet te heqim mendësi se, ka kush merret me ketë dhe me atë problem. Kryetari i shoqatës, nuk është masha dhe as koshi i asnjë anëtare kryesie. Secili të bej punën e vet. Nuk mundet që kryetari të merret me punën tuaj. Ai ka mjaft pune të tija, të cilat janë të përcaktuara në statut dhe që i dalin dhe i teprojnë. Mos u bëni shume të dijshtë, por secili të ulet e të zbatoje ato që kemi pranuar vullnetarisht, ato që i kërkohe, ato që i ka për detyre ti bej, e të tjera e të tjera. I theksojme këto se, jo në pak raste më keni penguar të bej punën time. Ketë kuptojni mire dhe të më mirëkuptoni drejt.

**Së dyti**, duhet të bëjmë përpjekje që nga vetja, të largohemi nga disa mendime të gabuara, në veçanti orientale, çka do të thotë UNI e PERJASHTIMI. Është interesant, që më shume merremi me ato që na ndajnë, të cilat janë më pak se sa ato që na bashkojnë



dhe për të cilat duhet të bëjmë shumë ti shumëfishojmë dhe ti bëjmë moton tone të bashkimit, pa të cilin nuk mund të zëmë vendin që na takon! Perse, ne duhet të ecim mbi bazën e disa strukturave të pushtesit osman, të cilave fëmijët tanë janë brezi i peste, që jemi larguar në kohe prej tyre?! Pse, ne ende kemi mendime raciste?! Pse, ne ende vijojmë të komunikojmë me një fjalor të huaj, në veçanti të atij turk? Pse, ne ende duhet të ndahemi në komunistë dhe në ballistë?! Pse, ne ende mendojmë të arrijmë në maje

të paarrishme, i cili vjen nga një mendim të një shoqërie primitive?! Të bëjmë përpjekje të jemi atje ku e kemi vendin se, vetëm në këtë mënyrë, do të pranojmë të tjerët të merren me ne! Pse, ende ne kërkojmë të matemi si shoqëri me mendësi të një shoqërie pa shtet, duke vrare, të cilën e ndalon feja dhe shteti?! Në shoqërinë tone dukagjinase ne periudhën 1991-2012 janë vrare 145 njerëz, madje edhe këto dite u vra një njeri. A duhet të na shqetësojë kjo gjendje?! Patjetër duhet të na shqetësojë dhe kemi

mundësi të reagojmë ashpër, në veçanti nëpërmjet gazetës dhe të veprimtarive të tjera. Pse, ende vijojmë të mbesim prapa pjesës tjetër të shoqërisë, në veçanti në zbatimin e disa riteve mortore?! Ne, nuk kemi pse të jemi prapa të tjerëve, përkundrazi mundësitë janë për më shumë, ne raport të drejte me pjesën tjetër të shoqërisë tone në të gjitha fushat.

\*Leon Tolstoj, dikur theksonte: "Të gjithë duan të ndërrojnë botën, por asnjë s'do të ndërrojë vetveten...". Prandaj, që ne të realizojmë mire misionin tone,

duhet që ne të jemi ndryshe në mendësi, të jemi ndryshe në marrëdhënie me të tjerët, të jemi ndryshe në planifikimin, në përgatitjen dhe realizimin e planeve tona me me kulture dhe vetëm me me kulture, duke prirë ne, me mendësi të kohës, larg atyre mendësive që na kthejnë në një shoqëri primitive. Por ne, nuk mund të ecim mire vetëm, pa marre me vete dhe intelektualët e tjerë dukagjinase. Aforizmi i Leon Tolstojte, të jete një thirrje për secilin nga NE!

REDAKSIA

## Urrejtje e shfrenuar ndaj çdo gjëje shqiptare në Mal të Zi, nuk duhet të jetë

REAGIM I SHOQATËS SË VËLLAZËRISË KOSOVË- MALËSI E MADHE "MARTIN DRESHAJ"

Viteve të fundit në Mal të Zi i është ngushtuar shumë hapësira fjalës së shkruar shqipe. Në emër të krizës "ekonomike" Podgorica ka shkurtuar minutat e emisioneve shqip në TV e po ashtu ka ndrydhur shumë edhe fjalën e shkruar shqipe. Në këtë situatë të rëndë është portali "Malësia.org" një dritare e hapur që plason të vërtetat për gjendjen në Malësi dhe në vendbanimet shqiptare atje. Janë në këtë Portal disa malësorë të rinj që vullnetarisht kanë marrë barrën e informimit të drejtë e me kohë të gjithë opinionit për rrjedhat e jetës së vështirë

të shqiptarëve atje. Kjo dritare informative ishte moti në sy të keq të ultra nacionalistëve malazez, që po i bënin vazhdimisht shantazhe e pengesa e po sulmonin këtë portal. Veprimi i fundit i disa "hakerëve" të ngarkuar keq me urrejtje e nacionalizëm ka krijuar indinjatë mes malësorëve dhe shqiptarëve në Kosovë, Shqipëri e kudo tjetër. Duke parë këtë akt të shëmtuar e duke lexuar se çfarë po porositnin këta huliganë, Shoqata e Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj" nuk mundi e të mos reagonte publikisht. I përshëndesim vëllezërit tonë

në Malësi dhe i porositim të qëndrojnë të fortë se nuk janë vetëm. Kurse ultra nationalistët dhe huliganët malazez i kujtojmë se gjuhën e lashtë shqipe nuk e heshti dot as romaku, as turku në shekuj e nuk do ta heshtin dot as ca hije të Zeza nga Karpatet. Fjala e bukur shqipe do të jetojë gjithmonë në Malësinë kreshnike dhe në gjithë trojet shqiptare. Fjala e bukur shqipe do të jetojë gjithmonë në Malësinë kreshnike dhe në gjithë trojet shqiptare.

Djelmoshat vullnetarë të Portalit "Malësia.org", po tregojnë edhe sot e

gjithë ditën se shqipja mund të atakohet, por nuk ka forcë as nuk ka hije të zeza që do ta ndalin fjalën e bukur shqipe në "Malësia.org". Ajo fjalë do të lexohet kudo në botë dhe është zë i fuqishëm i malësorëve dhe Malësisë. Staf i nderuar i këtij portalit tonë, vëllezër malësorë, Ju lumtë dhe vazhdoni me angazhimet se nuk jeni vetëm.

**RAHMAN JASHARAJ,**

zëdhënës dhe koordinator për trojet etnike i Shoqatës së Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj"

## FAMILJE E RESPEKTUAR

Familja Marku, është një familje e njohur, jo vetëm në qytetin, rrethin e Lezhës dhe më gjerë. Ky fis është i ardhur qindra vjet më parë nga krahina e Oroshit të Mirditës. Fati e desh që pas ikjes nga Oroshi të vendoseshin në malësinë e Lezhës. Familja Marku, përveç angazhimeve në bujqësi e blegtori, kanë pasur të zhvilluar edhe artizanatin. Krahas qëndrimit në fshat, falë zgjuarsisë të zotit të shtëpisë, kjo familje zbrit në qytet dhe vendoset në zonën më piktoreske të qytetit, pra në lagjen e kullave.

Sot, aty janë me dhjetëra shtëpi të kësaj familjeje. Familja e Ndue Frrok Markut është nder familjet e para të regjistruara në qytetin e Lezhës, e cila zotëronte prona në qytet e në fshat. Kjo familje, në regjistrat e viteve të para të pas çlirimit rezultoi të ketë qenë familje e mesme. Regjimi i kohës nuk shtetëzojë asgjë nga pasuria e tyre. Rezultonte se kjo pasuri ishte vënë me punën e djersën e tyre.

Edhe sot, pas shumë e shumë vitesh në saje të emrit të njohur, thonë jo vetëm të moshuarit por edhe moshat e reja, te kulla e Ndue Frrokut, te mullinjtë e Ndue Frrokut. Për të shkruar edhe me tej. Ndonëse djemtë e tij i kanë kaluar të 60 -tët e përsëri quhen djemtë e Ndue Frrokut. Janë shumë të nderuar e të respektuar në familje e në shoqëri. Për respekt të gjyshit Ndue, Mond Markut i ka venë emrin Ndue (Anton). Pjesëtarët e kësaj familjeje kanë qenë e janë të punësuar në vende me përgjegjësi. Por kurdoherë kanë punuar me ndershmëri e sinqeritet. Arritjet e tyre, janë të gjitha me punën e

djersën e tyre. Kjo është arsyeja që kjo familje sot, është e integruar në të gjitha fushat. Në arsim, shëndetësi, biznes e të tjera. Ka vetëm fjalë të mira për këtë familje dhe pjesëtarët e saj. Puna e tyre dallohet kudo. Mjafton tu shkosh në shtëpi, aty rrezaton kulture e pastërti. Shtëpi të bukura me gur të latuar me mjeshtëri, lule nga të gjithë kultivarët, pemë e hardhia të sistemuar bukur. Punime këto të kryera nga Bardhok e Pashk Marku. Pavarësisht se dikur Bardhoku ka punuar ne strukturat e pushtetit e të drejtësisë, tani është bërë specialist i punimeve me gur, por edhe kopshtar i shkëlqyer.

Ndue Frrok Markut, ka lënë tre djem e dy vajza. Të gjithë jetojnë shumë mire. Fëmijët i kanë të shkolluar e me punë të mira. Një pjesë merren me biznes, të tjerë në shëndetësi e sektor të tjerë. Në këtë shkrim po ndalem te djali i madh i Ndue Frrok Markut, Gjoni, i cili po u afrohet të 65 -tave. Në paraqitjen e pare të lenë përshtypjen e një 50 vjeçar. Burrë i pashëm dhe fisnik. Me shikimin e pare të bënë për vete, i veshur me shumë shije dhe të kohës. Kënaqësia e madhe është të pishë një kafe me Gjonin, pasi sjellja dhe komunikimi të krijojnë ndjesinë e një burri me horizont e kulture.

Dy vajzat e Gjonit kanë mbaruar fakultetin e mjekësisë, kanë mbaruar studimet për master e doktoratur. Nuk mund të gjeshe fjalë më të mira për dr. Valbona Gjon Marku (Martini) se, të gjithë qytetarët e Lezhës e më gjerë e falënderojnë për punën e kujdesshme që bën. Kurdoherë e gatshme për tu shërbyer

pacienteve të gjitha moshave. Pa daluar të pasur e të varfër, me poste e pa poste drejtimi. Fjalët e saj të shërojnë 50 për qind të sëmundjes pa përdorë ilaçe, sepse është fjala e mire dhe kuraja që i jep fillimisht pacientit. Kryesorja është se, nuk pranon ryshfete. Kjo e quan ofendim. Përgjigja e saj është, pa hipokrizi se më paguan shteti me taksat tuaja. Prandaj ju lutem mos më ofendoni!

Ndërsa vajza tjetër, Brunilda Gjon Marku (Rakaj) edhe kjo është mjekë, e cila ka përfunduar në Itali me nota të shkëlqyera, ka përfunduar studimet për doktraturë, me medalje ari. Rezultatet shumë të larta kanë bërë që mjekë Brunilden ta mbajnë në Itali, mjekë e pedagoge, duke konkurruar me dhjetëra e dhjetëra mjekë e mjekë Italiane. Tani, ajo është kthyer në idhull të shqiptarëve që banojnë në atë rajon. Me qellim, që të shërbejë më mire atdheut, para dy vitesh ajo kërkojë të kthehet në Shqipëri e të punojë si mjekë e pedagoge.

Dëshirë nuk ju realizua, pasi hasi në praktika burokratike. Madje thënie e autoriteteve të ngjasonin me ato të disa kuadrove pa shkollë në kohen e monizmit, të cilët kur vinin bursa për nxënës e student, nuk i shpërndanin, por i kthenin pas me pretekstin se, kur të mbarojnë shkollën do na zënë vendet. Kjo i ndodhi

edhe me mjekën Brunilda, e cila kërkojë të konkurronte. Përgjigja ishte e njëjtë me ato në monizëm, por më e kamufluar, kemi mjek shqiptarë. Po unë nga jam?-ju tha ajo. Ardhja e një mjekje e pedagogeje me një CV-i të shkëlqyer e me tituj shkencor, do ti bënte nder vendit e veçanërisht QSUT.

Në kuadër të aplikimeve për vende pune në TË të Kryeministrit të zgjedhur në mes të shumë të tjerëve është edhe aplikimi i mjekës Brunilda. Aplikimi i saj tërhoqi vëmendjen e kryeministrit të zgjedhur, Edi Rama. Në mes të valës së punës, ai gjeti kohen t' i përgjigjet. Duke shprehur mirënjohje për arritjet e Brunildes dhe për iniciativën që ka marrë, për tu kthyer në Shqipëri e për të kontribuar në mjekë shqiptare ... Mesazhet e shkëmbyera janë një ogur i mire dhe garanci për kthimin e mjekës Brunilda në Atdhe.

Kjo familje trashëgojnë genet e traditës, e bujarisë, e zgjuarsisë dhe inteligjencës, cilësi këto që e bëjnë këtë familje kryelartë për të kaluarën, të tashmen e të ardhmen. Është krenari edhe për miqtë, të cilët kanë lidhje me këtë familje.

**Ndue Ziçi**

REDAKSIA

Kryeredaktor: Lazër Kodra

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Luigj Shyti, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja